

Përgjegjësi për të mbrojtur vlerat e lirisë e demokracisë

Basha: " Është një përgjegjësi e madhe për të gjithë ne, që të mos i tradhëtojmë më parimet e shenjta të lirisë dhe demokracisë, të Shqipërisë së lirë dhe demokratike, për të cilën u flijuan të gjithë dëshmorët e betejës për çlirimin e Tiranës dhe në tërësi të luftës Nacionalçlirimtare"

FAQE 4



Lamtumirë Sokol Olldashi

EPITAF PËR SOKOLIN

Nga Teodor Laço

U këput e ra një yll;
Thonë mbeti në një pyll.
Nuk ka mbetur, shkoi në erë
S'mund të rrinte në humnerë
Të jetë me ne përherë.....

FAQE 8-9



ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 68 (299) DHJETOR 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tiranë. Email: veterani.obvl@yahoo.com/ website: WWW.VETERANIOBVL.ORG

T'i promovojmë dhe t'i shtojmë vlerat kombëtare

Nga Bujar NISHANI

101 vjet më parë, burra të shquar dhe të lavdishëm shqiptarë, të zotë të penës dhe të pushkës, që për Shqipërinë vetëm jepnin dhe për të marrë as mendja u shkonte, bënë të mundur shpalljen e Shtetit Shqiptar.

Nga koha kur më 28 nëntor 1912, me shtizën e duhur dhe në lartësinë e merituar, Ismail Qemali ngriti në Vlorë Flamurin kombëtar, për të ardhur sot në këtë 101 vjetor, u deshën shumë përpjekje, shumë mundime, shumë lodhje dhe shumë sakrificë.

Arritëm deri këtu, shpejt ose ngadalë, me apo pa gabime, për meritë të vetes por edhe me ndihmesën e të tjerëve, këto tashmë kanë rëndësinë e vet si Histori.

Në atë kohë, kufijtë e shtetit shqiptar u vendosën nga fuqitë e mëdha të cilat lanë padrejtësisht jashtë trungut, troje shqiptare.

Përtej kësaj padrejtësie të kohës, rëndësi ka që shtetin e bëmë, shtetin e kemi, dhe që ta mbajmë duhet t'i shërbejmë.

Me kokën lart', me vështrimin përpara pa harruar edhe ndonjë vështrim pas, tash e tutje duhet të kujdesemi dhe të punojmë; për më tepër begati, më tepër Liri, më tepër shpresë, më tepër prosperitet.

Mos mbetja mbrapa zhvillimeve globale ndaj një bote që ndryshon furishëm, kërkon shumë përkushtim, shumë idealizëm.

(vijon në faqen 9)

Takim jashtë axhende i kryebashkiakut Basha

Halil RAMA

Flamuj të ndryshëm e banderola të shumta zbukuruan kryeqytetin shqiptar me rastin e festive të pavarësisë dhe çlirimit të Atdheut. Kryeqyteti u "pushtua" ditë-ditës nga dekorimi festiv kuqez, ku...

FAQE 4

Presidenti Nishani, pritje me rastin e 101 Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë

TË PUNOJMË PËR MË TEPER BEGATI, LIRI, SHPRESE DHE PROSPERITET



FAQE 3

META: INSTITUCIONET SHTETËRORE DO TË JENË NË FUNKSION TË QYTETARËVE

Rrahman PARLLAKU:

• Halim Ramohito, luftëtari i orëve të para që u persekutua nga diktatura komuniste

• Meriban (Naideni) Qesja, shembull frymëzimi për të gjithë

FAQE 6

INTEGRIMI EUROPIAN DUHET TË MARRË MBËSHTETJE MBARËKOMBËTARE SI NJË PROJEKT QË TË PËRFSHIJË TË GJITHA PALËT POLITIKE DHE SHOQËRINË CIVILE

KOMISIONI I JASHTËM I PARLAMENTIT EUROPIAN: NË DHJETOR STATUSI I VENDIT KANDIDATPËR SHQIPËRINË

FAQE 10

70-VJETORI:

Rruga luftarake e Brigadës së IV-t Sulmuese

Brigada u organizua me katër batalione dhe kishte një efektiv prej 600 partizanë, por shumë shpejt gjatë luftimeve me armikun, ajo u dyfishua me partizanë vullnetarë të krahinave të Shqipërisë së Mesme...

FAQE 5

OFICERI I TALENTUAR QË NUK U SHKËPUT NGA VEPRIMTARIA E GJATË SHOQËRORE, PËRKUSHTUAR USHTRISË

Tom Dodani, skënderbegasi i përjetësuar në Bruksel

FAQE 10

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, deputetë dhe veteranë të OBVL-së, homazhe tek varrezat e dëshmorëve

TË NGREMË NË PIEDESTAL INTERESAT KOMBËTARE

Kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha, i shoqëruar nga grupi i tij parlamentar dhe veteranë të LANÇ, anëtarë të OBVL-së zhvilluan homazhe në nderim të dëshmorëve të Atdhëut, dhe vendosën kurora me lule në monumentin "Nënë Shqipëri".

Sipas Bashës, 28 Nëntori përveçse një ditë përkujtimi për dëshmorët është edhe një ditë reflektimi për vendimarrësit. "Le të jetë ky një burim frymëzimi, për të gjithë shqiptarët, dhe veçanërisht për vendimarrësit që të marrin vendimet e duhura, për t'i shërbyer vendit kombit, dhe për të lënë mënjanë interesat mesquine dhe për të ngritur në piedestal interesat kombëtare", tha Basha. Kreu i opozitës u ndal tek përgjegjësitë dhe tha se "Kjo është një ditë që kujton se përgjegjësitë tona nuk kanë mbaruar, por bazuar mbi këtë gur themeli të vaditur me sakrificë sublimë dhe gjakun e mijëra dëshmorëve ta çojmë përpara projektin e Shqipërisë, dhe shqipëtrëve si një faktor i rëndësishëm paqje dhe stabiliteti, por dhe si një nga kombet më të vjetra të qytetërimit Europian, destinacioni i të cilëve është padyshim Europa".

Në këtë ditë, sipas tij, "kujtojmë këta martirë, veprën e tyre, kujtojmë babain e Pavarësisë Ismail Qemal Vlorën dhe të gjithë bashkëpunorët e tij, të cilët 101 vjet më parë, përkundër vështirësive dhe

sfidave të panumërta ja dolën të shpallin pavarësinë në Vlorë. Kujtojmë sakrificën e qindra mijra shqiptarëve të tjerë për të konsoliduar shtetin e sapoformuar shqiptar, kujtojmë sakrificën e mijëra dëshmorëve të Luftës Nacional Çlirimtare që dhanë jetën për çlirimin e Shqipërisë dhe rrugëtimin e saj si një vend i lirë dhe demokratik", tha Basha.

"Kujtojmë Dëshmorët e demokracisë të cilët bënë të mundur përfundimin me sukses të kësaj ëndrrë shekullore që përbën dhe ribashkimin e shqiptarëve me familjen e madhe Euroatlantike. Kujtojmë bijtë e shqipes që dhanë jetën e tyre për lirinë e Kosovës, pavarësinë e saj dhe të drejtat shqiptarëve", shtoi më tej Basha.

Duke konsideruar miratimin në unanimitet nga Kuvendi, të propozimit të PD-se për të mbështetur statusin e kandidat të Shqipërisë në BE, si një hap të rëndësishëm, Basha tha se, "uroj që akti i djeshëm të shërbejë si një hap i rëndësishëm dhe në përputhje të plotë me aspiratat e atyre që u flijuan për pavarësinë e shqipërisë. Të mos mbetet një akt simbolik dhe i veçuar. Kjo ditë shërben për të ndërgjegjësuar të gjithë klasën politike shqiptare të vazhdojmë të përmbushim me besnikëri të plotë ndaj këtyre idealeve të gjitha detyrimet tona për të plotësuar kilometrat e mbetura për ribashkimin e plotë politik të Shqipërisë me Europën", tha Basha.



TIRANA FESTON 101 VJETORIN E PAVARËSISË

Tirana festoi e mbushur me aktivitetet 101 vjetorin e Pavarësisë. Qytetarë të shumtë u mbledhën në sheshet kryesore të kryeqytetit, duke u bërë pjesë e festimeve. Organizimet ishin gjithëpërfshirëse, ku në to janë bërë pjesë si fëmijët dhe të rriturit.

Atmosfera festive ka arritur kulmin falë performancave të Ansambllit Popullor të Këngëve dhe Valleve.

Të vendosur në sheshin pranë Galerisë Kombëtare të Arteve, rreth trupës së ansambllit janë

mbledhur shumë qytetarë, që kanë kënduar dhe vallëzuar me ta, këngë të shumta popullore.

Ndërkohë është hapur që në orët e para të mëngjesit të 28 nëntorit panairi në rrugën pedonale. Për të argëtuar më shumë qytetarët që vizitojnë standat e tij, aty pranë është vendosur të performojë këngë patriotike dhe Banda Frymore e qytetit.

Shumë qytetarë janë ndalur tek këndi i fotografisë, ku kanë fikuar në celuloid një kujtim të kësaj dite. Para një sfondi me momentin e ngritjes së flamurit 101 vjet më parë, aktorë të Teatrit të Metropolit të veshur si personazhet kryesor të ditës, kanë pozuar sëbashku me qytetarët. Atmosfera festive vazhdoi e tillë gjatë të gjithë ditës së 28 nëntorit.

NDERIM PËRJETË KOMANDANTIT LEGJENDAR ADEM JASHARI DHE HERONJVE QË LUFTUAN NË TROJET SHQIPTARE

Kryebashkiaku Lulzim Basha ka nderuar më 28 nëntor sakrificën e heronjve që dhanë jetën për lirinë e kombit shqiptar. Në këtë ditë, më të rëndësishmen në historinë e kombit tonë, kryebashkiaku Basha ka përkujtuar komandantin legjendar Adem Jashari, në 58 vjetorin e lindjes. Kurora me lule janë vendosur pranë shtatores së komandantit legjendar nga kryebashkiaku Basha, Këshilli Bashkiak, Ambasada e Kosovës, shoqata e veteranëve të Drenasit, të mbërritur në Tiranë, enkas për ceremoninë, shoqata e veteranëve shqiptarë të luftës së Kosovës etj. Në fjalën e tij kryebashkiaku tha se "Sot, më 28 nëntor festojmë edhe ditëlindjen e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari. Bashkë me sakrificën e mijëra e mijëra martirëve të kombit, kujtojmë sakrificën e familjes Jashari, dhe mijëra dëshmorëve, shqiptarëve jo vetëm nga



Kosova, Maqedonia, Presheva por anembanë trojeve shqiptare që luftuan luftën e fundit çlirimtare në Europë. Me këtë i dhanë fund njëherë e përgjithmonë robërimin të Kosovës, e çliruan dhe hapën rrugën e pavarësisë së saj, luftuan për të drejtat e shqiptarëve në trojet e tyre stërgjyshërore dhe i ngritën të dy kokat e shqipes njëherë e përgjithmonë, krenare në flamurin tonë", tha Basha. Kryebashkiaku i Tiranës shtoi gjithashtu se "Me krenari e mirën-

johje të thellë kombëtare, përkulemi para veprës heroike të komandantit legjendar të UÇK, Adem Jashari".

"Po kështu, me përgjegjësi të madhe për këtë vepër dhe domethënien e saj, shpreh bindjen se do të avancojmë kauzën e lirisë, demokracisë, mirëqenies së kombit shqiptar në tërësi dhe të çdo shqiptari, pavarësisht se ku jeton, në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës, të Maqedonisë apo kudo tjetër, si një detyrë madhore e brezit tonë, për të përmbushur atë pjesë të përgjegjësisë që na takon, me frymëzimi të madh nga sakrificë sublimë e komandantit legjendar dhe bashkëluftëtarëve të tij, me vendosmëri të palëkundur, për të kryer detyrën tonë dhe për ta çuar deri në fund amanetin e martirëve të luftës çlirimtare", tha ai.

PRESIDENTI OBAMA URON PRESIDENTIN NISHANI ME RASTIN E FESTËS SË PAVARËSISË

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Barack Obama uroi Presidentin e Shqipërisë Bujar Nishani me rastin e Festës së Pavarësisë.

Në mesazhin e urimit të Presidentit Amerikan Barack Obama drejtuar Presidentit të Republikës, Bujar Nishani me rastin e 101-vjetorit të Pavarësisë thuhet se, "si partner krenar dhe mik, Shtetet e Bashkuara iu bashkohen Ju dhe popullit shqiptar në festimin e Ditës së Pavarësisë në 28 nëntor".

Me tej, Presidenti Obama shkruan se, "SHBA dhe Shqipëria gëzojnë një partneritet të fortë e të veçantë të bazuar në interesa të për-

bashkëta. Unë e vlerësoj përkushtimin e Shqipërisë ndaj paqes dhe sigurisë globale përfshirë edhe përpjekjet tona të vazhdueshme e të përbashkëta në Afganistan, si edhe rolin e Shqipërisë në ruajtjen e qëndrueshmërisë në Ballkan".

"Pres, që të vazhdojmë dhe ta fuqizojmë marrëdhënien tonë në të ardhmen dhe ne zotohemi për mbështetjen tonë të plotë teksa vendi juaj përparon në rrugëtimin drejt integritit të plotë në bashkësinë euroatlantike. Pranoni, ju lutem, urimet më të mira të popullit amerikan në përvjetorin e Pavarësisë së vendit tuaj, përfundon mesazhi i Presidentit Obama.

SEQUI URON SHQIPTARËT ME RASTIN E 101 VJETORIT TË PAVARËSISË

Kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, Ettore Sequi, ka uruar 101 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë.

"Ndërkohë që Shqipëria përparon në rrugën e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian, angazhimi

i saj në axhenden e reformave dhe angazhimi i përtëritur politik ndërpartiak në reformat kyçe janë shprehje të rëndësishme dhe inkurajuese të aspiratave të forta evropiane të Shqipërisë", shprehet Sequi në mesazhin e tij.

Pritje me rastin e 101 Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë

TË PUNOJMË PËR MË TEPER BEGATI, LIRI, SHPRESE DHE PROSPERITET

Presidenti Bujar Nishani dha një pritje në Pallatin e Brigadave, në 101 vjetorin e shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë, ku të pranishëm ishin kryeministri Edi Rama, kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë dhe të partive politike, veteran të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, njerëz të medias dhe artist, si dhe të ftuar të tjerë. Në fjalën e tij përshëndetëse, Presidenti Nishani solli në vëmendje historinë e krijimit të shtetit shqiptar dhe shpalljen e Pavarësisë në 28 nëntor 1912. "Në atë kohë, kufijtë e shtetit u vendosën nga fuqitë e mëdha që lanë jashtë trugut padrejtësisht troje shqiptare. Rëndësi ka që shtetin e kemi dhe që t'a mbajmë, duhet t'i shërbejmë. Me kokën lart, me vështrimin përpara, pa harruar edhe ndonjë vështrim pas, tash e tutje duhet të kujdesemi e të punojmë për më tepër begati, liri, shpresë dhe prosperitet", u shpreh Nishani. "Sfida të vështira kemi për-

para, të fillojmë reformat e nevojshme", theksoi Presidenti, duke përmendur një sërë reformash sikurse ajo arsimore, strategjitet e punësimit, për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, etj. "Të bëjmë çmos t'a zbusim klimën politike, të ndërtojmë strategji të mira punësimi për të eliminuar lëmshat e padenja, Të vazhdojmë të punojmë edhe më tepër për sa na ka mbetur për afrimin me Evropën, të kujdesemi për fëmijët dhe brezin e ri që të jetë i pajisur me vlera qytetare, dashuri për dijen, patriotizëm, pasion për punën", vijoi më tej Presidenti. Nishani vuri theksin tek ruajtja e trashëgimisë kulturore, pasi, siç theksoi, "kultura mbetet, të tjerat konsumohen". Presidenti u ndal edhe tek vlerat kombëtare, duke nënvizuar dhe bashkëpunimin dhe mirëkuptimin me fqinjët. "T'a bëjmë Shqipërinë vendin e njerëzve që Shqipëria meriton, seriozë dhe të përmbajtur, zëmërdhenj, shpirtfisnisik, që e duan Atdheun", përfundoi Presidenti Nishani.



META: INSTITUCIONET SHTETËRORE DO TË JENË NË FUNKSION TË QYTETARËVE

Me mesazhin që të gjitha institucionet shtetërore do të jenë në funksion të qytetarëve, Kryetari i Kuvendit Ilir Meta hapi dyert e parlamentit për qytetarët, në kuadër të festave të 28-29 Nëntorit dhe rikthimit të "Natës së Bardhë".

Në fjalën e tij, Meta tha se 28-29 Nëntori, janë ditë mjaft të rëndësishme sepse na kujtojnë sakrificat e panumërta që kanë bërë të parët tanë në emër të lirisë, të së ardhmes së vendit dhe kombit tonë, të një perspektive më të mirë për gjeneratat e ardhshme.

"Për ne, kjo është jo vetëm një ditë nderimi e kujtimi por edhe një ditë angazhimi për të ardhmen në mënyrë që Shqipëria të jetë vërtetë një vend i realizuar evropian këtui dhe në mënyrë që të rinjtë e Shqipërisë, ta shikojnë të ardhmen në vendin tonë të përbashkët", deklaroi Kryeparlamentari.

Duke iu drejtuar vizitorëve të pranishëm në sallën e seancave plenare, Meta theksoi se pjesëmarrja juaj sot këtu, interesi juaj për të vizituar këtë institucion të rëndësishëm të zgjedhur nga qytetarët tanë, është një hap në drejtimin e duhur për të rritur kontrollin e qytetarëve ndaj këtyre institucioneve që ato të punojnë për të ardhmen e gjithë qytetarëve tanë.

Ai tha se kjo është një festë, jo thjeshtë për një natë, por edhe një mesazh i qartë i hapjes së institucioneve ndaj qytetarëve publikut, shoqërisë civile, medias dhe gjithë atyre që janë të bindur se në këtë vend, institucionet duhet të jenë në funksion të qytetarëve.

Gjithashtu, Kryeparlamentari vuri në dukje se jemi në një moment shumë pozitiv edhe në Kuvendin e Shqipërisë, atë të përpjekjes për të krijuar një klimë sa më bashkëpunuese, konstruktive, mirëkuptuese për të theksuar gjërat që na bashkojnë dhe që janë interes i për-

bashkët për qytetarët tanë.

Lidhur me marrjen e statusit të vendit kandidat, Meta tha se "janë të gjitha mundësitë sepse tre kushtet janë realizuar, zgjedhjet e 23 qershorit u vlerësuan, rekomandimet e KE-së për Këshillin e Ministrave të BE-së janë pozitive dhe sot u publikua mesazhi i Komisionerit Fyle drejtuar gjithë vendeve anëtar për të mbështetur për marrje e statusit të vendit kandidat, dhe shpresojmë dhe

tuar, për të plotësuar ëndrrat e të gjitha gjeneratave për një Shqipëri më të mirë, sa më të begatë dhe unë besoj se jemi në rrugën e duhur për të respektuar amanetin e të rënëve, por edhe për të përmbushur ëndrrën e gjeneratës më të re për ta bërë Shqipërinë plotësisht evropiane", tha kreu i Kuvendit, Ilir Meta.

Sipas tij, të gjithë i kemi të qarta sfidat e sotme, që kanë të bëjnë me forcimin e shtetit dhe me zhvillimin



besojmë se kjo gjë do të ndodhin".

Por Meta shtoi se "kjo kërkon konsensus dhe një votë pro nga të gjitha vendet anëtare. Do të mjaftonte edhe një hezitimim qoftë edhe i një vendi të vetëm, që kjo gjë të mos ndodhte por nuk ka asnjë arsye që Shqipëria të mos e fitojë statusin e vendit kandidat në muajin dhjetor para Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri".

NË RRUGËN E DUHUR PËR SHQIPËRINË EVROPIANE

Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, uroi festën e Çlirimit, 29 Nëntorit, në një aktivitet të përbashkët të organizuar me Kryeministrin Rama në kompleksin Xibraku në Tiranë. "Kjo ditë jo vetëm na ndihmon të kujtojmë sakrificat e të rënëve, por edhe na motivon për të qenë më të përkush-

e ekonomisë. "Jam i bindur se duke respektuar ata që ranë për lirinë e vendit dhe ata që kanë rënë për të forcuar shtetin, jemi në rrugën e duhur për të përmbushur ato aspiratat që na bashkojnë gjithë shqiptarët, për një Shqipëri evropiane, për një Shqipëri ku të gjithë ndihen të barabartë e të përfshirë", tha Meta. Gjithashtu kryeparlamentari përshëndeti Policinë e Shtetit për kapjen e 7 të arratisurve nga burgu i Drenovës. "Dëshiroj të përshëndes Policinë e Shtetit për provën e shkëlqyer që ajo kaloi ditët e fundit, duke i dhënë një goditje efektive krimin në vend, duke promovuar e testuar forcën e shtetit dhe të institucioneve", vlerësoi kryeparlamentari Meta. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm ministra, deputetë, si dhe veteranë e familjarë të dëshmorëve të Atdheut.

FESTOHET 101 VJETORI I SHPALLJES SË PAVARËSISË KOMBËTARE

Në qytetin e Vlorës, më 28 nëntor u festua 101 vjetori i Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare.

Në Sheshin e Flamurit, u zhvillua ceremonia zyrtare ku ishin të pranishëm Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Ilir Meta, Kryeministri Edi Rama, Ministri i Kabinetit, deputetë, përfaqësues të forcave politike e subjekteve fetare, të ftuar nga Kosova e Maqedonia.

Në fillim u zhvillua ceremonia e ngritjes së Flamurit, ndërkohë që më pas u vendosën kurora dhe u bënë homazhe në memorialin e Ismail Qemalit, në Lulishten e Flamurit, ku prehen edhe eshtrat e tij.

Meta, vlerësoi praninë e qytetarëve të shumta nga të gjitha trevat, duke përfshirë edhe Kosovën, të cilët ishin në Vlorë për të festuar me të njëjtën mirënjohje, këtë akt të madh të Ismail Qemalit dhe të gjithë patriotëve të tjerë. "Kemi hedhur një hap të rëndësishëm në këtë 1 vjetor të parë të 100 viteve që kanë hyrë tashmë për shtetin tonë, i cili po bëhet çdo ditë edhe më evropian dhe është kënaqësi që jemi sot bashkë këtu me Kryeministrin e Shqipërisë, zotin Edi

Rama, për modernizimin e këtij shteti dhe për plotësimin e aspiratës së të gjithë qytetarëve tanë për një Shqipëri evropiane, për një Vlorë evropiane, ashtu siç është përkatësia jonë, ashtu si do të jetë edhe e ardhmja jonë", u shpreh Meta.

Kryeministri Edi Rama u shpreh se, është kjo ditë është shumë emocionuese. "Për ne, që jemi këtu së bashku me kryetarin e Kuvendit dhe me bashkëkryetarin e Aleancës për Ardhmërinë Evropiane, është një ditë jo vetëm për t'u përlulur përpara atyre që themeluan shtetin shqiptar, por edhe për të rinëvizuar angazhimin e plotë që ndajmë në këtë ditë dhe në këto vite të para të 100 vjetorit të dytë të shtetit, ta çojmë Shqipërinë përpara, ta çojmë shtetin shqiptar përpara dhe njëkohësisht të rrisim edhe bashkëpunimin me të gjithë shqiptarët në të gjithë rajonin për të patur ditë më të mira për çdo shqiptar kudo që jeton", tha Kryeministri Rama.

Ai falenderoi dhe shprehu mirënjohjen për të gjithë ata që, sipas tij, kanë ardhur dhe i janë bashkuar në këtë festë, nga të gjitha trevat ku jetojnë shqiptarët.

PRESIDENTI I REPUBLIKES, BUJAR NISHANI, VIZITON FAMILJEN E PATRIOTIT OSMAN HAXHIU

Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, me bashkëshorten Odeta Nishani, zhvilloi një vizitë në mesditën e 28 nëntorit në familjen e patriotit vlonjat Osman Haxhiu.

Gjatë kësaj vizite, në kuadër të festës për 101 vjetorin e Pavarësisë, Presidenti Nishani shoqërohej dhe nga kryetari i Bashkisë, Shpëtim Gjika, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bujar Leskaj dhe drejtues të tjerë vendorë.

Gjatë bashkëbisedimit me pasardhës të patriotit Osman Haxhiu, Presidenti Bujar Nishani, u ndal tek dimensionet e figurës së tij dhe tek roli i tij në historinë e Vlorës dhe të Shqipërisë. "Kisha dëshirë të nderoj kujtimin e atyre që kanë dhënë shumë për Shqipërinë dhe familja juaj është një familje tradicionale me vlera të larta", theksoi Nishani, duke e cilësuar Osman Haxhiun një figurë qendrore të historisë.

FESTAT

Kryebashkiaku Basha dhe veteranët e OBVL, homazhe për të rënë në luftën për çlirimin e Tiranës

Përgjegjësi për të mbrojtur vlerat e lirisë e demokracisë

Basha: " Është një përgjegjësi e madhe për të gjithë ne, që të mos i tradhëtojmë më parimet e shenjta të lirisë dhe demokracisë, të Shqipërisë së lirë dhe demokratike, për të cilën u flijuan të gjithë dëshmorët e betejës për çlirimin e Tiranës dhe në tërësi të luftës Nacionalçlirimtare "

Tirana përkujtoi më 17 Nëntor 69-vjetorin e çlirimit. Një sërë aktivitetesh janë organizuar nga Bashkia e Tiranës, për të përkujtuar këtë moment historik.

Kryebashkiaku Lulzim Basha është përlur me nderim dhe respekt përpara veprës dhe kontributit të gjithë atyre që dhanë jetën për çlirimin e Tiranës. Zoti Basha, ndërsa bëri homazhe në varrezat e dëshmorëve, ka theksuar se është përgjegjësi e madhe për të gjithë ne, që të mos i tradhëtojmë më parimet

dhe është një ditë gëzimi por është një ditë që nis gjithmonë me nderimin për ata që flijuan gjithçka, edhe jetën e tyre, për një kauzë kaq të lartë e të pavdekshme, siç është liria, liria e atdheut, liria kombëtare, liria e qytetarëve.

Sot, përkulemi si çdo vit, me respektin më të thellë dhe mirënjohjen më të madhe ndaj atyre që mbetën të rinj përgjithmonë dhe që prehen në altarin e "Dëshmorëve të Atdheut", këtu në Tiranë apo kudo tjetër, duke nderuar kontributin dhe sakrificën e tyre sublime, duke përkujtuar jo thjesht fitoren e një



e shenjta të lirisë dhe demokracisë. "17 nëntori përkujton gjithmonë një ditë të veçantë për kryeqytetin, ditën e çlirimit të tij

siç është një përgjegjësi e madhe për të gjithë ne, që të mos i tradhëtojmë më parimet e shenjta të lirisë dhe demokracisë, të Shqipërisë së lirë dhe demokratike, për të cilën u flijuan të gjithë dëshmorët e betejës për çlirimin e Tiranës dhe në tërësi të

luftës nacional-çlirimtare. Përtej një dite përkujtimi, kjo është edhe një ditë refleksioni për përgjegjësitë tona sot e të brezave të ardhshëm, për të kultivuar e ngritur më lart vlerën e lirisë, vlerat e demokracisë dhe për të mos i lënë

më kurrë të ndihen "të tradhëtuara" këto ideale, për të cilat kemi paguar kaq shtrenjtë. Lavdi përjetë dëshmorëve të betejës për çlirimin e Tiranës, lavdi përjetë dëshmorëve të kombit! - deklaroi z. Basha. Homazhe në varrezat e dësh-

morëve të kombit në Tiranë, së bashku me kryebashkiakun Lulzim Basha bënë edhe kryetari i OBVL-së, Rahman Parllaku (gjeneral-letenant në pension, Hero i Popullit) si dhe disa veteran të tjerë të LANÇI, anëtarë të OBVL-së.

Takim jashtë axhende i kryebashkiakut Basha

Halil RAMA

Flamuj të ndryshëm e banderola të shumta zbukuruan kryeqytetin shqiptar me rastin e festive të pavarësisë dhe çlirimit të Atdheut. Kryeqyteti u "pushtua" dita-ditës nga dekorimi festiv kuqezi, ku përveç dekorimeve nga Bashkia e Tiranës, atmosferës festive iu shtuan edhe flamujt që qytetarët kishin vendosur në dritaret e tyre. Ndjenja e krenarisë kombëtare ishte më e evidente se kurrë edhe në selitë e bizneseve që ushtrijnë aktivitetin e tyre në metropolin shqiptar.

Një flamur gjigant kuqezi "sun-

doi" sfondin ballor të hotelit "Tirana". Të tillë flamuj të zinte syri edhe në fasadat e selive të institucioneve e atyre të bizneseve, partive e shoqatave.

Dhe jo vetëm kaq. Kryebashkiaku Basha, nënkryetari Enno Bozdo, gjithë stafi i bashkisë u përfshinë në një axhendë të ngjeshur përgatitjesh për këto ngjarje kulturore të historisë sonë kombëtare. Jo vetëm për vendosjen e flamujve e banderolave, por para së gjithash në veprimtari të shumta e të larmishme kushtuar festive të pavarësisë e çlirimit të atdheut. Dhe me gjithë axhendën e ngjeshur, kryebashkiaku

Basha "gjen kohë" që pas veprimtarive të takojë protagonistë të ngjarjeve të mëdha historike dhe pinjollë të tyre.

Nëse më 17 Nëntor ishte planifikuar vetëm përkujtimi i 69-vjetorit të çlirimit të Tiranës me një ceremoni nderimi e përluljeje të thellë para dëshmorëve që dhanë jetën 69 vjet më parë për çlirimin e kryeqytetit të shqiptarëve, pas kësaj ceremonie një takim jashtë axhende i kryebashkiakut Basha me veteranët të luftës ia shtoi madhësinë kësaj dite. U përkujtua kështu madhërisht një tjetër ngjarje në kuadrin e veprimtarive të plani-



fikuara për festat e Nëntorit.

Një kafe e përbashkët e kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha, njëherësh dhe kryetar i PD-së, me gjeneral Rahman Parllakun kryetar i OBVL dhe me veprimtarë të tjerë të kësaj organizate, veteranët

Sotir Budina, Isuf Imeraj, Jorgji Terca dhe një bashkëbisedim i ngrohtë e miqësor me ta për vlerat e LANÇI e domosdoshmërinë e mbrojtjes e transmetimit të këtyre vlerave tek brezat e ardhshëm që mjaftë impresionuese.

JUBILARE

Komandant i Brigadës u caktua Nexhip Vinçani dhe komisar Pëllumb Dishnica, dy nga kuadrot më me përvojë

Rruga luftarake e Brigadës së IV-t Sulmuese

Brigada u organizua me katër batalione dhe kishte një efektiv prej 600 partizanë, por shumë shpejt gjatë luftimeve me armikun, ajo u dyfishua me partizanë vullnetarë të krahinave të Shqipërisë së Mesme

Në fundin e vitit 1943 dhe fillimin e 1944-trës, kur lufta Nacionalçlirimtare kundra okupatorit fashist kishte marrë përpjestime të mëdha në të gjitha krahinat e vendit, për t'a goditur më me efektivitet armikun, lindi nevoja e krijimit të njëjësive të mëdha partizane. Kështu, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, pas krijimit të Brigadës së I-rë S, më 28 Dhjetor 1943, në Voskopojën me tradita patriotike e

Korçës, patriotë dhe revolucionarë të brumosur me ndjenja patriotike për çlirimin e vendit.

Përveç këtyre në Shtabin e Brigadës dhe në komandat e batalioneve u caktuan dhe shumë kuadro të dalluar në aksione dhe luftime të çetave partizane të qarkut të Korçës, si Vaskë Gjino, Petrit Dume, Spiro Shalësi, Pano Xhamballa, Zija Kambo, Gafurr Çuçi, Xhafer Lubonja, Gaqo Peristeri, Vera Pojani, Eleni Pashko, Fatmir Glata, Raqi Qirinxhi, Milo Qirko, Sotir Filto, Halit Mati etj, të cilët me përvojën dhe aftësitë e tyre të fituara në luftimet me armikun, dhanë një kontribut të madh në të gjitha luftimet që bëri kjo brigadë, që nga krijimi e deri në çlirimin e vendit.

Armiku ishte i alarmuar nga krijimi i Brigadës së IV-t S në qarkun e Korçës dhe i tronditur nga aksionet e befasishme dhe të vazhdueshme të çetave dhe batalioneve

partizane, të cilat me luftimet e tyre goditëse ishin bërë pengesë e madhe për lëvizjen e forcave gjermane nga Korça për në Greqi dhe në Jugosllavi. Gjermanët, me qëllim për t'i shpartalluar ato, me forcat e divizionit 100 të tyre të dislokuar në qarkun e Korçës (me një efektiv prej 900 kuadro e ushtarë dhe 1000 ballistë) si dhe me shumë forca të tjera armike nga Berati dhe Elbasani, ndërmorën dy operacione të mëdha: atë të Dimrit 1943 dhe atë të Qershorit 1944. Por me gjithë dëmet e mëdha që shkaktoi armiku me këto operacione, në të gjitha krahinat e qarkut të Korçës, duge djegur dhe masakruar shumë fshatra, nuk ia arriti qëllimit për t'i shpartalluar forcat partizane. Në këtë situatë të vështirë, batalionet territoriale dhe forcat e Brigadës së IV-t S, falë drejtimit të përsosur të komandantit të saj Nexhip Vinçani, heroizmit të partizanëve dhe mbështetjes totale të popullit të

krahinës së Korçës, jo vetëm përbaluan me sukses mësymjen e armikut dhe i shpëtuan rrethimit në këto dy operacione të mëdha, por e detyruan armikun të tërhiqet, duke pësuar humbje të mëdha në njerëz dhe teknikë luftarake.

Pas kësaj disfate që pësuan gjermanët në këto dy operacione, Brigada e IV-t S dhe batalionet territoriale, me goditje dhe luftime të vazhdueshme ndaj armikut, çliroi të gjitha krahinat e pushtuara nga gjermanët në qarkun e Korçës, atë të Gor-Oparit, Kolonjës, Mokrës, Pojanit, Devollit etj.

Pas luftimeve të suksesshme kundra pushtuesve gjermanë në Operacionet e Dimrit dhe Qershorit, Brigada e IV-t S, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇI, në maji 1944 u inkuadrua në Divizionin e I-rë S dhe mori pjesë në operacionin mësymës për çlirimin e Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Veriut. Në këtë operacion repartet e Brigadës së IV-t S, me luftime të shumta kundra okupatorit gjerman dhe forcave balliste, çlijuan krahinat: Qarishtë, Zërqan, Mat, Fushë Alie dhe në bashkëveprim edhe me çetat territoriale çlijuan edhe qytetet e Dibrës dhe të Elbasanit.

Në këto luftime të suksesshme për çlirimin e krahinave të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, repartet partizane të Brigadës së IV-t S patën një rritje të vazhdueshme, jo vetëm në përgatitjen luftarake, por në krahinat ku luftonin e dyfishuan efektivin e brigadës me partizanë vullnetarë të rinj, të cilët luftuan me vendosmëri dhe trimëri deri në çlirimin e plotë të vendit.

Pas luftimeve të shumta për çlirimin e Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Veriut, Brigada e IV-t S, së bashku me brigadat e I-rë, VIII-të dhe XVII-të, më 29 Tetor 1944, me urdhër të Shtabit të Korp Armatës së parë që drejtonte operacionin për çlirimin e Tiranës, mori pjesë në këtë operacion të rëndësishëm, kundër forcave të shumta të përqëndruara gjermane e balliste, për rreth kryeqytetit, me detyrë për të mbrojtur Tiranën dhe për të siguruar tërheqjen e trupave gjermane nga Greqia për në Jugosllavi. Në këtë operacion vendimtar për çlirimin e Tiranës dhe të gjithë vendit tonë, Brigada e I-rë u caktua të sulmonte armikun në veri të kryeqytetit, kurse Brigada e IV-tu caktua të sulmonte në drejtimin kryesor më të fortifikuar të kryeqytetit, në rrugën Elbasan-Tiranë, në sektorin Pallati i ri Mbretëror - Kodra e Kopilit - Kisha e Shën Prokopit, kurse Brigada e VIII-të u caktua të sulmonte në drejtimin: Gazerimat e Ali Rizajt, ndërsa Brigada e XVII-të u caktua të luftonte në Qafë Krrabë.

Repartet e Brigadës së IV-t S, gjatë 45 ditëve lufte të vazhdueshme me autokolonat gjermane në Qafë Krrabë



dhe me forcat gjermane që mbronin kryeqytetin, të mbështetura fuqishëm nga aviacioni anglo-amerikan, i cili çdo ditë bombardonte armikun nga Qafë Krraba në Tiranë, jo vetëm bllokoi lëvizjen e autokollonave armike, por pas luftimeve të rrufeshme trup me trup, në Betejën historike të Mushqetasë, arriti të shpartallojë dhe asgjësojë totalisht forcat gjermane.

Në këtë betejë shumë të përgati-

deri në çlirimin e plotë të vendit, Brigada e IV-të Sulmuese, duke qenë një nga njësitë më të suksesshme të Ushtrisë partizane, i plotësoi me nder detyrat e vëna dhe i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmjet të cilëve nën komandantin e Brigadës Pano Xhamballa, komandantin trim Xhafer Lubonja, partizanin Riza Taçi etj.

Rruga luftarake e Brigadës së IV-t Sulmuese, trimëria dhe heroizmi i




kulturore, u formua Brigada e IV-t Sulmuese, e cila gjatë luftës dha një kontribut të shquar për çlirimin e vendit.

Në këtë brigadë u inkuadruan partizanë dhe kuadro me shumë përvojë luftarake të fituara në luftimet me armikun, të batalioneve "Shqiponja", "Gor-Opar", "Tomori", "Çlirimi", "Fuat Babani", "Hakmarra", si dhe u dërgua një numër i madh vullnetarësh dhe kuadros nga qyteti i Korçës.

Brigada u organizua me katër batalione dhe kishte një efektiv prej 600 partizanë, por shumë shpejt gjatë luftimeve me armikun, ajo u dyfishua me partizanë vullnetarë të krahinave të Shqipërisë së Mesme.

Me Urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, komandant i Brigadës u caktua Nexhip Vinçani dhe komisar Pëllumb Dishnica, dy nga kuadrot më me përvojë luftarake, të sprovuar në luftimet kundra armikut në qarkun e



RRUGA LUFTARAKE E 4BrS (2200 KM)

tur dhe vendimtare për çlirimin e kryeqytetit, që e bëri Brigadën e IV-t S të lavdishme, armiku pati 500 të vrarë, 600 të plagosur dhe 400 robër, midis të cilëve 30 oficerë.

Brigada e IV-të Sulmuese, në betejën për çlirimin e Tiranës i dha atdheut 98 dëshmorë.

Në të gjitha luftimet, nga krijimi

luftëtarëve të saj në luftën për çlirimin e vendit, janë sot një burim i madh frymëzimi për gjithë popullin, dhe veçanërisht për rininë, në procesin e ndërtimit të demokracisë së vërtetë dhe mbrojtjen e atdheut.

Kolonel Sotir Budina
Ish-kuadër i Brigadës së IV-t S

HOMAZH

Homazh për gjeneralin që përfaqësoi denjësisht ushtrinë tonë në komandën e Traktatit të Varshavës.

Halim Ramohito, luftëtari i orëve të para që u persekutua nga diktatura komuniste

Nga Rrahman PARLLAKU

Të dielën, më 10 Nëntor 2013 u dha lamtumira e fundit Halim Ramohitos, njërit nga luftëtarët e orëve të para të Luftës Nacionalçlirimtare.

Halimin e kujtojmë djalë 16-vjeçar, pjesëmarrës në protestat e demonstratat e para antifashiste të nxënësve të Shkollës Tregtare të Vlorës, bashkë me shumë moshatarë e bashkëfshatarë të Tragjasit; të rinjtë dhe të rejat e këtij fshati që provoi i pari flakët e djegies nga fashistët, dhe që dhanë një kontribut të veçantë në Luftën Antifashiste në qarkun e Vlorës.

Në mes vashava e djemve të Tragjasit, Halimi u shqua jo vetëm për guxim e trimëri, por edhe si drejtues i rinisë antifashiste në qytetin e Vlorës, në Brigadën e V-të si zëvendës komisar batalioni në moshën 18-vjeçare dhe si përgjegjës i rinisë në Divizionin e V-të.

Halimi e përshkoi me luftë anë e kënd Shqipërinë, nga Vlora në Tropojë; drejtoi reparte luftarake në luftimet për çlirimin e Kosovës dhe vazhdoi më tej edhe në tokat e ish Jugosllavisë.

Pas çlirimit të vendit, Halim Ramohito kreu detyra në repartet e njësitë e ushtrisë; arriti detyra të larta në udhëheqje të ushtrisë deri si zv/drejtor politik.

Përfaqësoi denjësisht ushtrinë tonë në komandën e Traktatit të Varshavës.



Për meritat në luftë dhe kryerjen e detyrave në drejtimin e ushtrisë, Halimi u dekorua me 12 Urdhëra e Medalje Luftë e Shërbimi. Po ashtu ai mori gradën e lartë të gjeneralit.

Ishte një nga kuadrot e larta të Ushtrisë me kulturë e përgatitje profesionale dhe si i tillë përmbushi me sukses të gjitha detyrat e ngarkuara.

Por, edhe gjeneral Halim Ramohito, si shumë prej nesh u "shpërblye" nga regjimi diktatorial me persekutim, internim e burgim. Bashkë me të vuajti Ferdia, fëmijët e deri të afërmit e tij. Pasoja të këtij persekutimi i dëmtoan rëndë shëndetin atij dhe

bashkëshortes së nderuar, Ferdie.

Po edhe në këtë gjendje Halimi u përpoq të lerë diçka që mund t'i vlejë historisë: librin e parë me titullin e gjetur "Në shërbim të Atdheut". Shëndeti nuk e la të mbarojë librin e dytë, siç kish filluar ta shkruante.

Unë, duke qenë me Halimin gjithë periudhën e luftës në ilegalitet në qytetin e Vlorës, në një batalion në Brigadën e V-të dhe në Divizionin e V-të, si dhe për 20 vite bashkë në drejtimin e Ushtrisë, dhe duke jetuar si vëllezër në një banesë, ku Petriti e Vjollca kaluan bashkë me fëmijët e mi vitet e vegjëlisë, ruajmë e do ruajmë kujtimet më të mira për Halimin e të nderuarën Ferdie.

Edhe pasi u lirua nga kalvari i vuajtjeve i përtërimë lidhjet tona familjare, me gjithë fatkeqësinë që goditi shëndetin e Ferdies e Halimit, që e përcollëm me të gjitha nderimet që meritonte për në banesën e fundit.

Edhe njëherë ngushëllime fëmijëve, familjarëve e të afërmeve të Halimit.

Shpreh bindjen se Vjollca e Petriti do ta përballojnë dhimbjen e humbjes të babait e do ta shtojnë kujdesin për nënën.

I paharruar kujtimi i Halim Ramohitos!

Përkujtimore: Si u persekutua nga regjimi komunist, partizani i brigadës XXIII-të sulmuese, veterani i LANÇ

Hamit Metuku, veterani që u nda nga jeta në ditën e 100-vjetorit të pavarësisë

Një vit më parë, më 27 Nëntor 2012 u nda nga jeta partizani i brigadës së XXIII-të sulmuese dhe veterani i nderuar i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, Hamit Metuku. Ai lindi më 10 Tetor 1927 në fshatin Sh-tjefën të rrethit Mat.



Hamiti rrjedh nga një familje me tradita të larta patriotike, atdhetare dhe liridashëse. Në vitin 1944, në moshën 17 vjeçare, ju përgjigj thirrjes së Atdheut për të marrë pjesë si partizan në LANÇ. Fillimisht u aktivizua në Batalionin e Matit e më pas u inkuadrua në rradhët e brigadës së XXIII-të sulmuese, deri në çlirimin e plotë të vendit. Kontributi i Hamit Metukut, gjatë luftës, ishte shumë i vyer. Deri sa doli në pension, ai ka punuar në disa ndërrmarje shtetërore si, përpunim druri, gjeologji-miniera, ndërrmarje ushtarake etj. Gjatë gjithë punës së tij është karakterizuar nga shpirti i sakrificës, rigoroziteti, sinqeriteti dhe korrektesa. Ishte gojë ëmbël dhe fjalë pak, i dashur me shokët dhe kolegët e punës. Kudo ku ka punuar gëzonte respekt, ishte demokrat në shpirt e në zemër, ndjente gjithnjë dashurinë e madhe për Atdheun. Merrte pjesë rregullisht edhe në aktivitetet shoqërore dhe në përvjetorët e brigadës së XXIII-të sulmuese, ku ai ka qenë partizan. Ishte kundër mënyrës së organizimit dhe funksionimit të regjimit komunist, dhe si i tillë e mirëpriti dhe e përqafoj lindjen e regjimit të ri demokratik. Nuk pajtohej me rrymat e regjimit të kaluar, madje edhe pse kishte kontribuar në LANÇ, regjimi i asaj kohe e kishte "evidentuar" në listën e personave të persekutuar, vetëm e vetëm se i vëllai i tij, Bilali, kishte bërë krushqi me një familje të padëshiruar për regjimin komunist!

Hamiti ishte me "damkë" nga regjimi komunist, vetëm e vetëm se motra e tij Kadrija, ishte martuar me një "kulak"! Hamiti ishte me "njollë" nga regjimi i asaj kohe, vetëm e vetëm se motra tjetër e tij, Hikja, ishte martuar me një person, ku të afërmit e tij ishin arratisur jashtë shtetit! Një tjetër peshë të rëndë persekutimi, Hamiti, mori dhe rreth vitit 1976, ku nipi i tij, Xhemal Murati, nga fshati Barbullej i Matit, me detyrë drejtor në shkollën e mesme në Klos të Matit, i cili në një

mbledhje - aktiv, organizuar nga Komiteti Ekzekutiv i rrethit Mat, teksa informonte për problemet arsimore të shkollës ku ai drejtonte, u shpreh se: "Peshku është qelbur nga koka". Menjëherë pas kësaj që ndodhi, Hamiti u rëndua edhe më

shumë pesha e persekutimit, ndërkohë që nipi i tij, Xhemali, vuante dënimin e internimit në minierat më të thella të Martaneshit. Pas viteve '90-të, Hamiti ka banuar në qytetin e Tiranës. Ka lindur dhe rritur 9 fëmijë, nga këta, 8 djem dhe një vajzë, të gjithë të edukuar dhe të shkolluar. Për kontributin e tij, si në luftë ashtu dhe në punë, është dekoruar me urdhëra e medalje të ndryshme. Kontributi i tij në LANÇ është vlerësuar dhe nga institucionet e larta të shtetit. Që nga ajo kohë e deri në fund të jetës së tij, Hamiti ishte një qytetar i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë ata që e njohën. Banorët e pallatit dhe të lagjes ku banonte, shokët e tij veteranë me të cilët luftoi dhe jetoi një jetë të gjatë me ta, e patën atë shokun e tyre më të afërt, me të cilin flisnin e bisedonin për zemërsisht. Hamiti ishte natyrë paqësore dhe nuk donte t'u ankohej të tjerëve. E ruajti deri në fund të jetës së tij, imazhin kuptimplotë të njeriut të mirë. Moshë e tij 85-vjeçare nuk ia ndryshoi aspak arsyetimin e kthjellët, nuk ia ndërpreu aktivitetin fizik dhe nuk i dha asnjë pasojë që mund të vijë prej plakjes. U sëmurë dhe zuri shtrat jo për tu dergjur, por si për të bërë takimin e fundit me ata që i donte dhe e donin.

Ceremonia e varrimit e Hamit Metukut, për koiçidencë, u bë më 28 Nëntor 2012, në ditën e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ceremoni e cila u bë me të gjitha nderet që i takonin dhe e meritonte. Hamiti vdiq dhe u varros, por la të gjallë punën, veprën dhe kontributin e tij, la bashkëshorten e tij Mexhiden dhe vajzën e tij Lefterien, la dhe 8 djemtë e tij; Bashkimin, Samiun, Feritin, Aliun, Astritin, Dritanin, Andonin dhe Edmondin; la dhe shumë nipër dhe mbesa, la të afërm, miq e shokë që do ta kujtojnë gjithmonë me nderim të veçantë. Hamiti do të jetojë përjetësisht në kujtesën e të afërmeve të zemrës së tij.

Meriban (Naideni) Qesja, shembull frymëzimi për të gjithë

Më 14 Nëntor 2013 u nda nga jeta në moshën 90-vjeçare, Meriban Qesja (Naideni), bashkëlufëtaria dhe aktivistja e OBVL-së.

Meribani lindi në një familje me tradita të larta patriotike. Ishte mbesë e Hoxhë Vokrit (Said Naidenit), i njohur për veprimtarinë e tij patriotike në interes të atdheut.

Në moshën e fëmijërisë, Meribani bashkë me prindërit erdhi nga Dibra e Madhe në Tiranë. Këtu mbaroi shkollën fillore. Sipas zakonit të atëhershëm bëhet vajzë shtëpiake. Po kjo nuk e pengoi të shprehë ndjenjat e saj patriotike dhe të përfshihet që në orët e para në Lëvizjen Antifashiste e të bëhet një luftëtare e vendosur, shembull për rininë e vajzat e Tiranës.

Me aktivitetin e saj luftarak, Meribani dha një kontribut të veçantë në mobilizimin e organizimin e vajzave e grave në Lëvizjen Antifashiste, të cilat u bënë mbështetje e madhe për luftëtarët ilegalë në kryeqytet.

Unë, për herë të parë e takova Meribanin në gusht 1944 në Priskë të Tiranës, kur merrte pjesë në një takim me të rinjtë të Tiranës që kishte organizuar Gogo Nushi, drejtues i luftës në Tiranë. Ai më njohu me Meribanin; më tha se ishte një vajzë shtëpiake, por që me aktivitetin e guximit e saj në luftë bëri që t'i dëgjohet zëri e të respekto-



het edhe nga gratë e vajzat intelektuale. Për kontributin e saj në luftë dhe më pas në vitet e rindërtimit, Meribani është nderuar me Urdhëra e Medalje Luftë e Pune. Pas luftës, Meribani ka punuar e drejtuar organizatat e masave e në administratat shtetërore. Kudo që punoi, çdo detyrë e plotësoi me devotshmëri e ndershmëri dhe gëzoi respektin e kolektivit. Meribani me të paharruarin, bashkëshortin e saj, Xhavitin, krijuan një familje model, ashtu siç ishin vetë model në shoqëri. Asaj i ra barra të rrisë dhe edukojë fëmijët, sipas karakterit e ndershmërisë së prindërve të tyre. Kjo, për faktin se bashkëlufëtari ynë i paharruar, Xhav-

iti, vuajti mbi 20 vjet internim e burgim për arsye se ballë për ballë me diktatorin Enver Hoxha, si rrallë kush mbrojti idetë demokratike. Po ashtu u qëndroi presioneve të jashtëzakonshme edhe brenda hekurave të burgut.

Mua më ndoqi i njeiti fat si i të paharruarit Xhavit; u bashkuam në qelitë e burgut të Burrelit ku u përsërit shoqëria që u forcua edhe pas lirimit nga burgu kur morëm pjesë në krijimin e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare. Xhavitit e Meribani qenë nismëtarë të kësaj organizate dhe dhanë kontributin e tyre në mbarëvajtjen e saj. Po rëndimi i shëndetit të tyre erdhi si pasojë e persekutimit e vuajtjeve psikologjike, por për Xhavitin edhe fizike në kushtet e burgut ferr të Burrelit. Madje këto vuajtje ndikuan edhe tek Meribani në një lëngim të zgjatur.

Kështu ua shpërbleu diktatura sakrificat e kontributin që dhanë këta dy luftëtarë të shquar për çlirimin e Atdheut.

Me vdekjen e Meribanit, fëmijët humbën nënën e tyre të dashur, e nderuara Nexhi humbi motrën që i shërbeu me aq dashuri; ne veteranët humbëm një bashkëlufëtare të shquar.

I paharruar qoftë kujtimi i saj!
Rr. Parllaku
(Fjala në ceremoninë mortore)

IN MEMORIAM

Nga Shoqata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës

NDEROHEN DËSHMORËT MAZLLUM KËPUSKA E DËRGUT VOKSHI

Në kuadrin e manifestimeve që Shoqata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, gjatë gjithë këtij viti, po mban në shenjë të 70-vjetorit të Konferencës Themeluese të Këshillit Nacional-Çlirimtar të Kosovës dhe të Rezolutës historike të Bujanit, të shtunën, më 23 nëntor, në sallën universale të Pallatit të kulturës "Asim Vokshi" në Gjakovë është mbajtur tubimi përkujtimor me rastin e 70-vjetorit të pushkatimit nga fashistët të dëshmorëve gjakovarë Mazllum Këpuska e Dërgut Vokshi. Familjarët e dëshmorëve, veteranët e qytetarët e pranishëm i përshëndeti kryetari i Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, Vehap Shita, kurse për jetën dhe veprën e Dërgut Vokshit dhe Mazllum Këpuskës, foli prof. Xhevat Koshi, sekretar i Shoqatës së Intelektualëve "Jakova".

Gazetarja Ilirana Pylla recitoi poezitë e Esad Mekulit "Popullit Tim" dhe "Landovicës", ku, para 70 vjetësh, janë pushkatuar dy dëshmorët partizanë. Në fund për familjen Vokshi foli dr. Mark Palnikaj, nga Malësia e Gjakovës, ku është mbajtur Konferenca e Bujanit.

Vehap Shita, shkrimtar:
GJAKOVA KA DHËNË SHUMË TRIMA, SHUMË BURRA, DJEM E VAJZA QË E KANË NDERUAR VENDIN, ATDHEUN

Gjakova me rrethinë me të drejtë mburret me trimat, me atdhetarët që i kanë dhënë emër Gjakovës në luftërat çlirimtare të Kosovës e të shqiptarisë që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri te lufta çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, - tha, përveç të tjerash në fjalën e vet përshëndetëse, kryetari i Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, - . Gjakova me rrethinë kanë dhënë shumë trima, shumë burra, djem e vajza që e kanë nderuar vendin, atdheun.

Në të gjitha periudhat e luftërave çlirimtare Gjakova me rrethinë e ka dhënë pa kursim hisen vet si pjesë e këtij vendi, e këtij procesi. Gjakova me rrethinë me të drejtë mburret me trimat, me atdhetarët që i kanë dhënë emër Gjakovës në luftërat çlirimtare të Kosovës e të shqiptarisë që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri te lufta çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjakova me rrethinë kanë dhënë shumë trima, shumë burra, djem e vajza që e kanë nderuar vendin, atdheun.

Sot po përkujtojmë dy dëshmorë partizanë të këtij qyteti: një student të ri, ish-nxënësisë të Gjinnazit të Shkodrës dhe një, ushtarak të karrierës, të dy ish-luftëtarë partizanë që ranë të përfaqar nga plumbat e armikut nën okupacionin fashist. Të dy ishin nga Gjakova - bij të qytetit dhe të rrethit të Gjakovës: Dërgut Vokshi, bir i një familjeje të njohur patriotike të Gjakovës, dhe Mazllum Këpuska, bir i një familjeje të ndershme të Gjakovës.

Prof. Xhevat Koshi:
TË PËRQAFUAR U PUSHKATUAN NGA FASHISTËT ITALIANË

Në rrugën e Çabratit në Gjakovë qëndron një kullë dykatëshe me frëngji, të cilën e ngriti, jetoi dhe jeton familja Vokshi nga Gjakova, e shquar në zjarrin e përpjekjeve luftarake e bujare, me ide liridashëse, patriotike e përparimtare. Në këtë kullë familjes Vokshi, shekuj me radhë, e brez pas brezi i lindën djem e vajza që kurrë dhe askush nga ata

nuk mbeti pasiv, as që u hamend për ta mbajtur të gjallë emrin e nderit e të atdhedashurisë. Kjo familje patriotike i dha atdheut dy heronj të kombit Sylejman e Asim Vokshin, dhe shumë të tjerë me vlera të larta patriotike e të sakrificës për mëmëdheun, si Beqir, Sabrije (nënë Bija), Xhafer, Dërgut Vokshi e shumë të tjerë. Në këtë familje me 1911 lindi Dërgut Vokshi, vëlla i Asimit, Miftarit, Xhaferit e Shahzades.

Dërguti së bashku me hallën e tij, Nënë Bijen, ishin bërë shembull frymëzimi për shumë patriotë shqiptarë. Edhe sot e kësaj dite, i biri i Dërgut dhe i Memë Vokshit - Shefqeti me tre djemtë e tij i mbeti besnik rrugës së të parëve. I burgosur dhe i maltretuar, Shefqeti me djemtë e tij Milotin, Shpendin dhe Adriatikun, ishte i përfshirë aktivisht në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe edhe sot vepron si anëtar i Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Çlirimtare.

E kaluara, jo e largët, për Shqipërinë dhe shqiptarët shënoi ditë të rënda. Pasi Shqipëria, në vitin 1912, shpall pavarësinë e Shtetit Shqiptar, Konferenca e Ambasadorëve të fuqive të mëdha, që u mbajt në Londër në vitin 1913, pa përfaqësuesin e Shtetit Shqiptar, për interesat e tyre, u vunë në shërbim të fqinjëve tanë grabitqarë dhe lejuan aneksimin e më shumë se gjysmës së terrioreve të Arbërisë në favor të shteteve që na rrethonin. Bashkë me pjesën e aneksuar, shkoi edhe gjys-



ma e popullsisë së kombit tonë. Kështu të copëtuar, ishim gjithnjë e më të pafuqishëm për t'i dalë zot vatanit. Veriu i Shqipërisë, Kosova, e cila ishte edhe pjesa më e madhe e shkëputur nga trungu amë, iu aneksua Serbisë.

Breza të tërë të rinisë kosovare, sidomos të atyre nga Gjakova, edhe pse me vështirësi, rreziqe e sakrificat të mëdha, e kalonin kufirin për t'u strehuar e shkolluar në Shqipëri.

Atdhedashës dhe entuziastë të arsimit shqip

Me 1939 Italia fashiste e okupoi Shqipërinë. Prej atëherë fillon rezistenca kundër okupatorëve fashistë. Pjesëmarrës aktivë ishin edhe nxënësit nga Kosova, të cilët ishin të inkuadruar në grupe ilegale komuniste e antifashiste të Shqipërisë. Njëri ndër këta atdhedashës dhe entuziastë të arsimit shqip ishte edhe Mazllum Këpuska, atëherë nxënësisë i

Gjinnazit të Shkodrës.

Në Gjakovë, në rrugën e Çabratit, në muret e një shtëpie të vjetër, qëndron një pllakë përkujtimore e mermertë e cila është dëshmi se në këtë shtëpi ka lindur Mazllum Këpuska.

Mazllumi lindi me 1921 në një familje të varfër të Gjakovës nga nëna Elmaze (Vula) dhe babai Jahja Këpuska. Si bashkëqytetarët e tjerë, edhe familja Këpuska, në ato kushte të robërisë, mezi mbijetonte. Mazllumi dhe motra e tij e hasretit mbetën pa nënën e tyre që në moshë të vogël. Kushtet e rënda ekonomike bënë që Mazllumi i vogël të strehohej në një familje gjakovare në Shkup, ku kaloi fëmijërinë e hershme. Mësimet e para i filloi në Gjakovë, por nuk arriti t'i përfundonte dhe kaloi ilegalisht në Shqipëri. Në Krumë të Hasit, ku ishte dikur selia e Prefekturës së Kosovës, vazhdoi shkollimin fillor të cilin e kreu me sukses. Në vitin shkollor 1936-37 regjistrohet në Gjinnazin Shtetëror në Shkodër. Këtu Mazllumi takohet me një grup të rinjsh kosovarë, kryesisht nga Gjakova, si Fadil Hoxha, Emin Duraku, Ismet Shaqiri, Ymer Pula, Xhevdet Hamza etj.

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, grupet ilegale të rinisë përparimtare antifashiste fillojnë aktivitetet për çlirimin e atdheut. Edhe pse i ri për nga mosha, Mazllumi, pa u hamendur u bashkohet këtyre grupeve që atëbotë ishin formuar edhe në Gjinnazin e Shkodrës. Në demonstratën e 28 Nëntorit 1939 në Shkodër, kur ishte nxënësisë i klasës së tretë të gjinnazit të Shkodrës, Mazllumi dallohet si pjesëmarrës revolucionar i pakompromis.. Për pasojë, u arrestua bashkë me një grup shokësh dhe u dërgua në burgun e Tiranës. Për shkak të moshës jomadhore dhe për mungesë të provave, u lirua nga burgu dhe u kthye në Shkodër për të vazhduar shkollimin.

Pas largimit nga Gjinnazi i Shkodrës kthehet në Tiranë, ku punoi si punëtor në një depo të ushqimeve. Këtu shokët i sillnin literaturë përparimtare të kohës. Kështu Mazllumi brumoset me ide patriotike. Në mesin e shokëve dallohej me guximin dhe vendosmërinë e tij. Këto ishin cilësitë që ndikuan në formësimin e personalitetit të tij si luftëtar trim dhe i vendosur. Këto tipare i shpaloste gjithandej kah e kërkonte detyra.

Sypatrembur, i vendosur në aksione dhe flakadan në beteja

Mazllumi, për nga natyra ishte djalosh i qetë dhe i dashur, i ndershëm, i ndjeshëm dhe human, i afërt dhe i matur, por mbi të gjitha ishte i guximshëm, sypatrembur, i vendosur në aksione dhe flakadan në betejat në të cilat morri pjesë. Në mesin e shokëve thoshte: "pa na i mbështetur tytat e armëve në gjoks, pa na kapur plumbi në rrashtë nuk do të kemi kthim pas - vdekje fashizmit - liri popullit..."

Në fillim të vitit 1942, sipas vendimit të partisë, Mazllumi së bashku me Fadil Hoxhën, bëjnë atentatin e parë kundër armikut. Prej atëherë kalon në ilegalitet dhe vazhdon punën dhe luftën për çlirimin e vendit. Ishte pjesëmarrës në aksionet që i organizonte Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në aksionet partizane e betejat që zhvilloheshin.

Në vjeshtën e vitin 1942, me vendimin e udhëheqjes së Lëvizjes e të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kalon në Aradhen Partizane



"Zenel Ajdini", ku si aktivist i spikatur, iu besua udhëheqja e aktivitetit të Rinisë Antifashiste e më vonë edhe e ndihmës komisarit dhe e komisarit të Aradhes Partizane "Emin Duraku" me komandant Fadil Hoxhën. Ai, në shumë aksione e beteja, përveç trimërisë, dallohej me vetëmohim, pjekuri politike, gatishmëri për t'u flijuar.

Dhe, si luftëtar i guximshëm e strateg në luftën guerile, Mazllum Këpuska zgjidhet zëvendës komisar politik i aradhes partizane "Emin Duraku", funksion ky të cilin e mbajti deri në maj të vitit 1943.

Në analet e LANÇ Mazllum Këpuska përmendet në shumë raste si pjesëmarrës i dalluar në aksionet e kësaj Aradhe në Shën Mëri, Llojan, Turjakë etj. Me formimin e batalionit "Bajram Curri", emërohet komisar politik i Batalionit.

Mirëpo, Mazllum Këpuska ishte shëndetlig. Prej vuajtjeve e mundimeve të mëdha, si partizan është sëmurdë disa herë, por me vullnetin dhe entuziazmin e tij të pashoq e të çeliktë nuk epej para shokëve dhe kështu mundahej ta përballonte sëmundjen, sepse kurrsesi nuk mund ta mendonte veten jashtë aradhes dhe aksioneve të saj.

Duke e parë se gjendja e tij shëndetësore gjithnjë përkeqësohej, shokët e këshilluan që të kthehej në Gjakovë për t'u mjekuar e për ta marrë pak veten. Kështu ai, bashkë me Dërgut Vokshin, kthehen në Gjakovë dhe vendosen në shtëpinë e Dërgutit në të cilën jetonte Miftar Vokshi, shtëpi kjo që ishte bazë partizane. Për fat të keq, hetohen nga spiunët e kohës, të cilët lajmërojnë okupatorët dhe ata rrethojnë shtëpinë. Rezistenca, për shumë arsye, ishte e pamundur, kështu që në mëngjesin e 17 qershorit 1943, Mazllumi dhe Dërguti arrestohen. Torturat e tmerrshme të asaj nate, që i përjetuan në karabinierinë e Gjakovës, nuk mundën t'i gjunjëzojnë

patriotët, për të nxjerrë nga ata së paku një fjalë të vetme për organizimin e LANÇ dhe shokët e luftës. Menjëherë pas arrestimit lajmërohet shoku i tyre Vehap Shita, i cili ndodhej i strehuar në Konviktin e Shkollës Teknikë në Kavajë. Vehapi, siç deklaroi ai vetë, e merr në telefon mikun e tij të shtëpisë Beqir Malokun, i cili ndodhej në Tiranë dhe ishte mjaft autoritativ në radhët e pushtetit aktual, dhe,, përveç të tjerash, i thotë: "Keni një rast të mirë që të rehabilitoheni nëse ndërmerrni diçka për ta shpëtuar Mazllum Këpuskën që ka bërë atentat kundër Jush, dhe Dërgutin, që është bir i familjes së njohur Vokshi të Gjakovës, stërnipi i Sulejman agë Vokshit, komandant i Ushtrisë së Lidhjes së Parë Shqiptare të Prizrenit e vëlla i luftëtarit të Spanjës Republikane, Asim Vokshit..."

Beqiri i premton se nesër do të jetë në vendin ku mbahen të arrestuar dhe se do të bëjë të pamundurën për t'i liruar. Premtimin e dhënë Beqiri nuk arriti ta mbante pasi që të nesërmen në mëngjes (më 18 qershor 1943), me një kamion, i kishin nisur gjoja për në Prizren, por rrugës, në Landovicë, kamioni ishte ndalur gjoja për një defekt dhe këtu, të lidhur, i pushkatojnë me pretekst se gjoja kishin tentuar të ikin.

Humbja e Mazllum Këpuskës dhe Dërgut Vokshit, u përjetua shumë rëndë nga shokët e familjet e tyre. Për shokët që e njohën mirë Mazllum Këpuskën, ai mbeti kandil i pasuar në rrugën e ardhmërisë. Mazllum Këpuska, siç cilësohej sypatrembur, i dha fund jetës në përfaqim me shokun e tij të luftës, Dërgut Vokshin. E Dërgut Vokshi, i brumosur me ide liridashëse, si edhe të tjerët nga familja Vokshi, kishte një jetë pasur ushtarake e partizane - gjithnjë në të mirë të popullit dhe në shërbim të atdheut.

HOMAZH

Veteranët e OBVL, kurorë me lule në nderim të deputetit demokrat

Lamtumirë Sokol Oldashi

Nën reshjet e dendura të shiut, familjarë, miq, kolegë politikanë, të medias dhe mijëra qytetarë, i kanë dhënë më 21 Nëntor lamtumirën e fundit deputetit të Partisë Demokratike, ish ministrit të Brendshëm dhe të Transporteve, Sokol Oldashi, i cili u nda nga jeta mbrëmjen e 20 Nëntorit, pas një aksidenti në aksin rrugor Tiranë-Elbasan.

Shtëpia, Kuvendi dhe më pas banesa e tij e fundit u bënë vendi i respektit ndaj politikanit që kishte vetëm një qëllim lirinë.

Homazhet nisën mëngjesin e të enjtes (21 Nëntor) pranë shtëpisë ku ai jetonte për të vazhduar në Kuvendin e Shqipërisë, ku për më shumë se dy orë, deputetë, krerët e lartë të shtetit, miq dhe qytetarë kanë kryer homazhe para arkivolit të deputetit të ndjerë të vendosur në hollin e Kuvendit. Sheshi para Kuvendit ishte i mbushur plot me

Shqipëria ishte në zi më 21 Nëntor. Flamujt u ulën në gjysmështizë në nderim të deputetit dhe ish-ministrit Sokol Oldashi, i cili humbi jetën në një aksident tragjik në aksin Elbasan-Tiranë mbrëmjen e 20 Nëntorit. Kuvendi i Shqipërisë u mbulua me një vello të zezë. Nën tingujt e muzikës funebre dhe me lule të bardha në duar, të afërm, miq, qytetarë e kolegë, që hera-herës nuk arrinin ti mbanin lotët, i dhanë lamtumirën e fundit deputetit Sokol Oldashi.

vendosi një kurorë me lule pranë arkivolit me trupin e pajetë të Sokol Oldashit.

Homazhet zgjatën deri në orën 14:00, dhe më pas trupi i pajetë i deputetit u përcoll mes dhimbjes së madhe, për në banesën e fundit. Ndërkohë, Bashkia e Tiranës vendosi që flamujt në kryeqytet të ulen në gjysmë shtizë gjatë periudhës së

ar nga bashkëshortja e tij, Kryeministri Rama u përkul përpara trupit të pajetë të deputetit Oldashi, u shprehu ngushëllimet familjarëve të deputetit dhe më pas la edhe një shënim në librin e kujtimeve.

Qeveria shpall ditë zie kombëtare
Shqipëria ishte në zi më 21



sa shpenzimet e varrimit dhe të ceremonialit u përballuan nga institucioni organizator i ceremonialit.

EPITAF PËR SOKOLIN

Nga Teodor Laço

*U këput e ra një yll;
Thonë mbeti në një pyll..
Nuk ka mbetur, shkoi në erë
S'mund të rrinte në humnerë
Të jetë me ne përherë.....*

Nishani: Gjurma e jetës së tij nuk do të shuhet kurrë

Rreth orës 13:45, Presidenti i Republikës Bujar Nishani, i shoqëruar nga bashkëshortja e tij, u përkul me nderim përpara trupit të pajetë të deputetit Sokol Oldashi dhe më pas, ngushëlloi dhe u dha kurajo familjarëve të tij. Më herët në një mesazh ngushëllimi, Presidenti Nishani shprehet: "Në këto çaste të rënda, kur përjetojmë me hidhërim të thellë humbjen e papritur të personalitetit të jetës shqiptare, deputetit Sokol Oldashi, shpreh ngushëllimet më të ndjera e të sinqerta familjes së tij. Do ta kujtojmë Sokol Oldashin për kontributin e tij të gjithanshëm në jetën politike e publike në vend, për përpjekjen e tij të palodhur për demokracinë. Do e sjellim ndërmend Sokol Oldashin si një zë të fortë, këmbëngulës në kryerjen e detyrave që i qenë ngarkuar që në fillimet e karrierës së tij si gazetar dhe më vonë si politikan. Familja e tij të jetë e sigurt se do ta ndjejë përherë ngrohtësinë jo vetëm të atyre që e kanë njohur nga afër, gjurma e jetës së tij nuk do të shuhet kurrë dhe në

jemi mbledhur, për t'i dhënë përshëndetjen e fundit Sokol Oldashit, do të donim të mos vinim kurrë. Në këtë humbje kaq tragjike dhe kaq të parakohshme, të gjeshe fjalët e duhura për mikun, për shokun dhe liderin e shumë betejave politike dhe njerëzore, është shumë e vështirë. Sepse sot, të gjithë së bashku, jemi duke jetuar një makth të tmerrshëm dhe të pabesueshëm. Na duket sikur nga çasti në çast, do të zgjohemi nga ky makth dhe nga kjo gjëmë e papritur. Nuk na besohet dot të mos e shohim Sokolin gjithnjë në këmbë, gjithnjë në krye, me pamjen e tij të vendosur e të hijshme, me buzëqeshjen e tij të rrallë, ku çiltërsia rinore u kishte rezistuar për mrekulli viteve të moshës së burrërisë dhe pjesëmarrjes së zjarrtë në sa e sa beteja politike", tha ndër të tjera kryetari i PD- Lulzim Basha.

Berisha: Oldashi jeton dhe do të jetojë midis nesh

Në fjalën e mbajtur për mediat në përfundim të homazheve Berisha deklaroi, "Ndahemi me njërin nga djemtë më të talentuar, zërat më të fuqishëm, qeveritarët më eficientë, personalitet, i cili është shënuar në memorien e kohës me vepra të pavdekshme, ngushëllimet e mia më të sinqerta familjes, miqve dhe të afërmeve. Sokol Oldashi jeton dhe do të jetojë midis nesh me veprën e tij, me trashëgiminë e tij, për Partinë Demokratike, për vendin e tij, për kombin e tij".

Nano: Do i mungojë politikës, shoqërisë dhe të ardhmes

Në homazhe mori pjesë edhe ish-Kryeministri Fatos Nano, ashtu sikundër qindra mijëra personalitete të tjerë. Në fjalën e tij Nano tha, "Sokoli ishte një nga ne, politikanët e tranzicionit, me sakrificë

këtë bindje le të gjejë forcën për ta përballuar këtë humbje kaq të rëndë. I paharruar qoftë kujtimi i Tij!"

Basha: Sokoli do të jetë një impuls dhe forcë për të gjithë

Me lot në sy, pasi takoi familjarët Basha shkroi dhe një përshkrim në librin e kujtimeve. Më pas, nderimet vazhduan nga ish-Kryeministri Sali Berisha, familjarë, deputetë të Grupit parlamentar demokrat, grupeve të tjera parlamentare, Trupi Diplomatik dhe mijëra qytetarë. Fjala e lamtumirës u mbajt nga kryetari i PD-së, i cili tha se Sokoli ishte dhe është një luftëtar që do të jetë impuls dhe forcë për të gjithë. "Këtu ku sot



qytetarë, politikanë dhe diplomatë të akredituar në Tiranë në pritje për t'i bërë homazhet dhe për t'i dhënë lamtumirën e fundit Kollit dhe për t'i shprehur ngushëllimet familjes. Homazhet e mbajtura në Kuvend në nderim të deputetit të ndjerë u çelën nga kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha. Në Kuvend ishin edhe familjarët dhe dy djemtë e deputetit të ndjerë, të cilët u përpoqën të tregoheshin të fortë, në vendin ku babai i tyre ka mbrojtur me vendosmëri kauza të rëndësishme, ka patur debate të forta e replika, duke u bërë një zë i fortë i Partisë Demokratike.

Në emër të veteranëve të OBVL-së, kreu i degës së Tiranës të kësaj organizate, Jorgji Terca

homazheve për deputetin e Partisë Demokratike, Sokol Oldashi.

Homazhe edhe nga Rama e Meta

Kryetari i LSI-së, njëherësh kreu i Kuvendit Ilir Meta, bashkë me ministrat, deputetët dhe përfaqësues të tjerë të LSI-së, zhvilluan homazhe në nder të deputetit të ndjerë Sokol Oldashi. Pasi u përkul përpara trupit të pajetë të deputetit dhe ngushëlloi familjarët e deputetit Oldashi, mes dhimbjes zoti Meta ka lënë edhe shënimin e tij në librin e kujtimeve. Kryeministri Edi Rama i është drejtuar Kuvendit, për të kryer homazhe në nderim të deputetit Sokol Oldashi, pas një vizite në Londër. I shoqëru-

Nëntor. Flamujt u ulën në gjysmështizë në nderim të deputetit dhe ish-ministrit Sokol Oldashi, i cili humbi jetën në një aksident tragjik në aksin Elbasan-Tiranë mbrëmjen e 20 Nëntorit. Kuvendi i Shqipërisë u mbulua me një vello të zezë. Nën tingujt e muzikës funebre dhe me lule të bardha në duar, të afërm, miq, qytetarë e kolegë, që hera-herës nuk arrinin ti mbanin lotët, i dhanë lamtumirën e fundit deputetit Sokol Oldashi.

Këshilli i Ministrave e shpalli të enjten e 21 Nëntorit ditë zie kombëtare në nderim të të ndjerit, Sokol Oldashi. Sipas vendimit të qeverisë, në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike flamuri kombëtar u ul në gjysmë shtizë, ndër-



cat, kontributet dhe debatet që shoqërojnë politikën. Ajo që shton dhimbjen është se iku pa radhë, do i mungojë politikës, shoqërisë dhe të ardhmes".

Përcjellja për në banesën e fundit

Deputeti Sokol Olldashi u përçoll në banesën e fundit rreth orës 14:50 të datës 21 Nëntor 2013. Të afërm, miq, personalitete të larta të politikës dhe artit, kolegë dhe qytetarë të shumtë nuk munguan edhe në ceremoninë mortore të zhvilluar në Sharrë për t'i dhënë lamtumirën e fundit deputetit Sokol Olldashi. Në ceremoninë e ndjekur nga qindra të pranishëm nën tingujt e muzikës funebre, ka folur deputeti demokrat, Astrit Patozi, ish-kreu i Grupit të PD-së. "Do të na mungojë, jo thjesht humori i tij i papërsëritshëm, edhe në situatat më të rënda, por mbi të gjitha, sensi i optimizmit edhe në ditën më të zezë, edhe në kohën më të keqe. Dhe kjo është shenja e parë dhe më e qarta, që i dallon burrat e fortë nga njerëzit e zakonshëm. Sokol



vet, i pjekur shumë para kohe, edhe për shkak të një jete të vështirë, arriti ta provojë veten dhe t'ia dalë, duke mbajtur barra tepër të rënda

nga kjo botë i vetëm, edhe pse ishte personazhi, më me shumë miq, që unë kam njohur ndonjëherë", tha ndër të tjera në fjalën e lamtumirës Patozi.

Bashkuara në pranverë dhe unë i thashë se do e prisja me kënaqësi takimin me të në anën tjetër të Atlantikut" thekson Arvizu. "Mendimet dhe lutjet e mia më të ndjera dhe të kolegëve të mi të Ambasada-s Amerikane janë me familjen, miqtë dhe mbështetësit e tij në këtë kohë të vështirë" shkruan ambasadori amerikan ne kete mesazh ngushellimi. Edhe ambasadori i Bashkimit Europian, Eto Sekui i shpreh ngushëllime në emrin e tij dhe në emër të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë familjes së deputetit Sokol Olldashi pas humbjes së tij tragjike natën e kaluar. Mendimet e kolegëve tanë janë me familjen e tij, miqtë e tij dhe kolegët e tij parlamentarë në këtë moment të trishtuar" shprehet në mesazhin e tij ngushëllues ambasadori Sekui.

publike të vendit. Nën tingujt funebër të orkestrës dhe ceremonialit Protokollar të shtetit kortezhi përçolli për në banesën e fundit, trupin e deputetit Sokol Olldashi.

Diplomatët, homazhe për deputetin demokrat

Trupi diplomatik i akredituar në Tiranë ka zhvilluar homazhe në nderim të deputetit demokrat, Sokol Olldashi. Kreu i Prezencës së OSBE, Florian Rauning, Ambasadori i Gjermanisë, Helmut Hoffman, e të tjerë kanë qenë të pranishëm në ambjentet e Parlamentit për të zhvilluar homazhe dhe shprehur ngushëllimet ndaj familjes Olldashi.

Në një mesazh ngushellimi, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara Alexander Arvizu shpreh trishtimin e tij për këtë ngjarje. "Kam qenë me fat që pata mundësinë ta njihja gjatë kohës sime në Shqipëri, dhe do ta kujtoj gjithnjë si dikë që e donte shumë Shqipërinë dhe dëshironte që ta bënte vendin e tij një vend më të mirë, për të gjithë. Kur e takova për drekë disa javë më parë, më tregoi sa shumë e shijonte mundësinë për të kaluar më shumë kohë me familjen e tij. Më tregoi për planet që kishte për të vizituar Shtetet e

Qindra mesazhe në librin e ngushëllimeve

Në librin e shënimeve të hapur për ceremoninë mortore, si dhe për mediat që përcollën drejtpërdrejt këtë ceremonial, u shprehën mesazhe të shumta nga personalitetet më të larta të vendit. Ata ndër të tjera vlerësuan figurën e deputetit Sokol Olldashi, si një zë aktiv dhe me oratori të spikatur në jetën politike dhe

Një figurë e nderuar e Partisë Demokratike

Ai u përfshi me lëvizjen e dhjetorit në vitin '90, ku që në atë kohë ai u bë anëtar i Partisë Demokratike si dhe anëtar i mbledhjes themeluese të Forumit Rinor të Partisë Demokratike. Nga Maji i vitit 2002 deri më Shtator të 2007-ës, Olldashi mbajti postin e Kryetarit të Forumit Rinor të Partisë Demokratike. Në vijim, nga muaji maj 2005-Maj 2009 ai ka qenë Kryetar i Partisë Demokratike të Tiranës si dhe anëtar i Kryesis së PD-së që nga viti 2002. Gjithashtu nga qershori i vitit 2001, Olldashi ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, një herë përfaqësues i qarkut të Durrësit dhe në dy legjislaturat e fundit përfaqësues i qarkut të Fierit. Gjatë karrierës së tij politike, Olldashi ka mbajtur postin e Ministrit të Brendshëm, gjatë drejtimit të së cilës ai shënoi suksese të rëndësishme në luftën kundër bandave më të rrezikshme kriminale duke i kthyer vendit dhe qytetarëve sigurinë publike. Ai ka mbajtur gjithashtu postin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, duke punuar fortë me projektet e qeverisë për shndërrimin e infrastukturës rrugore së Shqipërisë në një infrastrukturë me standarde europiane. Sot arteriet kryesore rrugore të vendit mbajnë firmën e Sokol Olldashit. Sokoll Olldashi, lindi me 17.12. 1972 në qytetin e Durrësit. Pasi mbaroi gjimnazin në shkollën e mesme të përgjithshme "Naim Frashëri" në Durrës, ai ndoqi studimet në Fakultetin e Tiranës, në Univeritetin e Tiranës dhe më pas në vitin 2004 ndoqi Kolegjin e Mbrojtjes, pranë Komandës së Doktrinave (Politikat e Sigurimit Kombëtar). Karrierën e tij profesionale, Olldashi e nisi si Kryeredaktor në televizionin ATN1, më pas ai punoi si zëvendëskryeredaktor për politikën në gazetën "Albania" si dhe si reporter pranë Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH). Ai ishte i martuar dhe kishte dy fëmijë.



Olldashi ishte një shqiptar i madh, dhe unë këtë e them me bindjen time më të thellë, edhe pse për këto fjalë asnjëherë nuk do ta merrja miratimin e tij. Në këtë botë dhe në atë tjetrën, ku po e përcjellim sot, me pikëllim. Por jo nga ai soj shqiptarësh, që mendojnë për ta shkruar me dorën e tyre historinë e vet. Dhe si i tillë hyri në histori. Një përfaqësues brilant i brezit të

në një moshë fare të re. Dhe ruajti të njëjtin ritëm dhe të njëjtin ekuilibër, që nga dita e parë, kur vendosi të marrë përsipër gjëra të mëdha. Dhe gjithçka e arriti vetë, pa marrë asnjë dhuratë Krishtlindjeje, që nga dita e parë, e deri mbrëmë, në çastin, kur u shua. Pa i hyrë në borxh askujt, por duke na bërë të gjithëve borxhlinj. Ndaj edhe me sa duket, vendosi të ikë

T'i promovojmë dhe t'i shtojmë vlerat kombëtare

Nga Bujar NISHANI

(Vijon nga faqja 1)

Sfida të vështira kemi përpara. Të vijojmë reformat e nevojshme. Të vijojmë reformën arsimore. Që shkollat të na prodhojnë njerëz të thellë në dije dhe mendime, të aftë për të përballuar sfidat e mëdha të punëve të mëdha të së nesërme. Të bëjmë çmos ta zbusim klimën politike ndërpartiake. Të ndërtojmë strategji të mira punësimi për të evituar sa të mundim pak nga pak lëmshat e padenja dhe jo-efikase asistenciale. Të vazhdojmë të punojmë edhe më tepër për sa na ka mbetur për

afrimin me Europën. Të kujdesemi për fëmijët, dhe në përgjithësi për brezin e ri. Që brezi i ri të jetë i pajisur me vlera qytetare, edukatë, respekt, dashuri për dije, patriotizëm, pasion për punë. Në të kundërt, s'kemi pse habitemi kur të rinjtë na vriten nëpër kafene, në aksidente rrugore, apo nga krimi në familje. Të kujdesemi më tepër për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Dhe ta pasurojmë atë trashëgimi. Nëse nuk prodhojmë Kulturë për t'ja shuar trashëgimisë, nuk i kemi dhënë asgjë kombit, është krejt njëjloj sikur nuk kemi bërë asgjë. Sepse Kultura mbetet. Të gjitha të tjerat konsumohen. Vetëm në këtë mënyrë do të

mundësojmë stabilitet më të madh, progres më të harmonishëm në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat. Ndërkohë, t'i promovojmë dhe t'i shtojmë vlerat kombëtare. Por pa e tepruar. Në mënyrë dhe masë të ekuilibruar. Se diktaturat merren me veten, me glorifikimin e vetes. Demokracitë funksionojnë në harmoni edhe me të tjerët. Demokracitë ecin më fuqishëm së bashku, me fqinjët sidomos, me të cilët duhet të jemi mirëkuptues edhe më bashkëpunues në të gjitha aspektet. Në fund të fundit, sado të vjetër dhe të lavdishëm, me Gjuhë të pasur, Kulturë dhe Histori të lashtë, jemi një Komb si gjitha kombet e tjera. Në këtë këndvështrim, na duhet t'i kthejmë sytë nga vetja, të

përveshim llërët, të ndreqim gabimet dhe të ecim përpara. Të mos lejojmë që Shqipëria të bëhet Atdheu i njerëzve sipërfaqësorë të babëzitur për pasurim material, vend i luftës së papërmbajtur politike, fushëbetëje e fanatikëve të çdo lloji. Ta bëjmë Shqipërinë vendin e njerëzve që Shqipëria meriton, vendin e njerëzve seriozë dhe të përmbajtur, njerëzve zemërmëdhenj me shpirt fisnik, që punojnë shumë, pak mendojnë për veten dhe shumë për tjetrin, që duan atdheun, që njohin meritën e tjetrit, që nuk e teprojnë me të drejtën. (Fjala e Presidentit të Republikës në prujtjen me rastin e 28 Nëntorit)

AKTUALITET

Integrimi europian duhet të marrë mbështetje mbarëkombëtare si një projekt që të përfshijë të gjitha palët politike dhe shoqërinë civile

KOMISIONI I JASHTËM I PARLAMENTIT EUROPIAN: NË DHJETOR STATUSI I VENDIT KANDIDAT PËR SHQIPËRINË

Raportuesi për Shqipërinë, Vuljaniç, vëren se ka patur një progres mjaft premtues në axhendën e reformave dhe shpreh besim në potencialin, kapacitetin dhe vendosmërinë e Shqipërisë drejt integrimit evropian

Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Europian, Niko la Vuljaniç, ka paraqitur në Komisionin për Politikën e Jashtme të Parlamentit, rezolutën për Shqipërinë, ku rekomandohet dhënia e statusit të vendit kandidat në dhjetor. Kjo rezolutë, që përmban 18 pika, do të jetë në qendër të diskutimeve për marrjen e statusit të vendit kandidat në muajin dhjetor në Parlamentin Europian. Në dokument përfshihen vërejtjet e progresraportit të Komisionit Europian për Shqipërinë, si edhe ecuria e reformave të nevojshme që ka ndërmarrë Shqipëria bazuar në rekomandimet e BE-së. Në rezolutë vlerësohet fryma e bashkëpunimit dhe sjellja e forcave politike gjatë zgjedhjeve të 23 qershorit, pasi dhe integrimi europian duhet të marrë mbështetje mbarëkombëtare dhe duhet të jetë një projekt që të përfshijë të gjitha palët politike dhe sho-

qërinë civile. Raportuesi për Shqipërinë, Vuljaniç, vëren se ka patur një progres mjaft premtues në axhendën e reformave dhe shpreh besim në potencialin, kapacitetin dhe vendosmërinë e Shqipërisë drejt integrimit evropian.

"Dua të theksoj këtu që vendi po vlerësohet për progresin e arritur gjatë një viti. Komisioni ka bërë një raport për progresin e Shqipërisë nga tetori i 2012 deri në verën e këtij viti. Pra, nuk është se u ndërrua qeveria dhe hopa gjithçka bëhet menjëherë pozitive tani. Nuk është qeveria në pushtet autorja e suksesit", u shpreh eurodeputeti Bernd Posselt. Nga ana tjetër, të njëjtin mendim me të shprehu edhe eurodeputeti Knut Fleckelein, sipas të cilit nuk është tranzicioni i pushtetit që është çelësi i suksesit. Suksesi, sipas tij, ka ardhur si rrjedhim i një pune të konsiderueshme që është bërë më parë.

Në vijim të këtyre diskutimeve, eurodeputeti Elmar Brok ka theksuar se një progres edhe më i madh mund të ishte arritur nëse opozita e atëhershme e drejtuar nga Rama do të ishte si opozita e sotme, atëherë vendi do të kishte më shumë progres. "Madje mund të shtoj këtu, që situata do të kishte qenë shumë më ndryshe, nëse opozita e atëhershme do të sillte si opozita sot", deklaroi Brok. Sipas tyre, Shqipëria e meriton statusin për progresin që ka bërë dhe autorësinë e suksesit e mban qeveria e mëparshme për reformave të realizuara.

Ndërkohë pjesë e rezolutës janë dhe një sërë kërkesash ndaj vendit tonë si psh të bëhen përpjekje të mëdha për të forcuar pavarësinë dhe eficientësinë e sistemit të drejtësisë, duke shtuar këtu edhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Kërkohej që të përmirësohet dhe forcohet puna e autoriteteve që merren me të drejtat e njeriut, siç



janë Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit; të qartësohet roli dhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të monitorohen të gjitha strategjitë antikorrupsion. Rezoluta kërkon të bëhen përmirësime në luftën kundër krimit të organizuar dhe në metodologjinë hetimore.

Në rezolutë përgëzohet qeveria

për mbështetje ndaj punësimit, por i kërkohej që të garantojë respekt për të gjithë të punësuarit, qoftë në sektorin privat apo publik.

Rezoluta vlerëson ndër të tjera dhe rolin stabilizues të Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në marrëdhëniet me shtetet fqinje, ku ka një komunitet të konsiderueshëm shqiptarësh.

Oficeri i talentuar që nuk u shkëput nga veprimtaria e gjatë shoqërore, përkushtuar Ushtrisë

Skënderbegasi i përjetësuar në Bruksel

Jeta e tij qe një sfidë për lirinë, për mbrojtjen kombëtare, për familjen që e deshi me aq përkushtim, për miqtë e shokët që nuk do t'i harroj kurrë as në përjetësi dhe ata do ta mbartin me vete, në këtë jetë dhe në të gjitha jetët e tjera si një rekuem malli e dashurie të pashuar...

Nga Mark DODANI

Tom Dodani, nga shkolla "Skënderbej", deri në gradat më të larta, teksa dha shpirt në krahët e Albanit të tij, me dorën në parzem të të birit, la mesazhin: "As vdekja nuk do të më pengojë t'iu dua përgjithmonë. Ruajeni përzemërsinë!"...

Ky mesazh shpërndau tinguj muzikal anëkënd Brukselit, në mbretërinë e Belgjikës, mbushur me shqiptarë. Jemi në Brukselin historik, pra mirënjohur kryeqytet i Europës perëndimore, kësaj Europe zëhyjnore, me demokracinë e saj të kulluar e brilante.

Pasi kishte shërbyer 45 vjet si ushtarak, fillimisht shkollat "skënderbegas", vazhduar më tej pa ndërprerje shkollën e lartë ushtarake, për degën e Kimisë, përkreu të gjitha ciklet me notën "shkëlqyer". Nisi shërbimin në moshëm të re, oficer, kimist, specialist i Ushtrisë, në Divizionin e Shkodrës. Nuk iu nda asnjë ditë, asnjëcast përgatitjes intelektuale, me lexime të shumta, me një vullnet të fortë për të nxënë gjithçka e për ta vënë në shërbim të një modeli vlerash qytetare e njerëzore, për kombin e tij.

Pajisur me të gjitha aftësitë, arsimin dhe kulturën e gradës superior, Toma përfaqësoi Shqipërinë në

Kinën e Madhe, ku vetë kryeministri i atëhershëm ngarkoi edhe Tomën të përfaqësoje Shqipërinë në atë delegacion madhor ku ishte dhe vetë ai, kryeministri, që kryente dhe detyrën e lartë të minsitrit të Mbrojtjes.

Arritur në moshën e pensionit del oficer në rezervë. Asnjëherë, megjithatë, nuk u shkëput nga veprimtaria e gjatë shoqërore, përkushtuar Ushtrisë. Për këtë flet fakti domethënës në përbërje të shoqatës zëmadhe "skënderbegase", ku kryente funksionin e nënkryetarit.

Në ditët e para të janarit 2012, të gjithë flisnin me zjarr për kremtë madhor të Pavarësisë, më 28 nëntor, por Toma nuk ishte. Një sëmundje e rëndë e mori në krahët e përjetësisë, jashtë atdheut, pikërisht kur donte aq shumë të ishte i pranishëm në kremtin e këtij jubilee historik. Por ja, e paparitura ndodhi, Toma dha jetën në Brukselin epokal, kryeqyteti historik i Euroës modern.

Në kujtesën e drejtpërdrejtë të Albanit, djalit guximtar, i kthjellët, bujar e korrekt ndaj detyrës, besnik ndaj babait dhe krejt të parëve të tij, u krye përcjellja e dhimbshme e oficerit madhor shqiptar, Tomë Dodani për në banesën e përjetshme.

Ani pse u varros në Brukselin e lashtë, larg tokës së të parëve, nder-

imi që u organizua nga Albani i Tomës, në marrëveshje me personalitetet e vendit ku shquhej brukselasi belg Franck Robensyn, ishte një ngushëllim i thellë për të gjithë të pranishmit.

Brukselasi gjeneroz Franck Robensyn ishte shefi organizator dhe drejtuesi i ceremonialit të këtij funerali të paharruar, të një ushtaraku të lartë, që mbolli në tokën e tij ëndrrat më të bukura për jetën...

Në orën 11 e 15 minuta, ky belgi mirënjohur, drejtoi ceremonialin funebre, me një ecuri kronometrike të pa parë, nisur nga morgu në kishë, dhe në destinacionin e fundit, në vendvarrimin hyjnor të trupit të oficerit shqiptar, Tomë Dodanit.

I nderuari F. Robensyn, fillimisht, na drejtoi nga morgu në kishën katolike Bruksel. Hirësia e Tij, prifti, çoi meshën mbresëlënëse blatur shpirtit të Tomës. Arkivoli mbuluar me flamurin kombëtar kuq e zi dhe shqipopnjën dykrenare qëndron përballë altarit të shenjtë, gjithë dhimbje në sytë e përlotur të të pranishmëve, të cilët sapo kishin mbyllur përshëndetjen e fundit me Tomën qysh në morg.

Mesha e predikimit fetar mori një kohë rreth dy orë.

Me një kulturë të lartë kishtarë, Prifti, më dha fjalën, pasi sapo mby-



lli predikun e tij, kushtuar Tomës, në frëngjisht. Fola në altar pranë priftit. Fola shkurt rreth jetës së tij dhe mesazhit të lënë, që nuk do të mund të pengohet as nga vdekja, për tëna dashur gjithmonë dhe që të ruajmë përzemërsinë, pa harruar të përmendja njeriun shpirtdhembshur zezak, i cili kishte përjetuar fundin, minutë pas minute, të jetës së tim vëllai. Njeriu me ngjyrë Afrikës Jugore që i pranishëm me ne, familjarët e Tomës dhe në morg. Ai kujtonte Tomën në heqjen e fundit të frymës, në dhomën etrishtë spitalore, në Bruksel, vënë kryet dhe shpatullat në gjoksin e të birit, të cilit i lëshon grahmën: "Ah, Albani em! Ti je Albani em?!" Dhe me këtë grahmë ai mbylli sytë për herë të fundit në këtë jetë, shtrënguar në gjoksin e të birit, mbytur në një det lotësh, teksa lotët e tij binin në fytyrën e njeriut me ngjyrë që e kishte përfaquar fort nga dhembshuria...

Ndërkohë Linda Dodani, mbesa e Tomës, lexoi fjalën mallëngjyese

të Temes, fluturuar me avion nga Durrësi-Tiranë e Shqipërisë, arritur në Bruksel, ngritur në këmbë me leje të priftit në altar, lexoi fjalën prekëse të Temes dhe motrave të tjera të tij: "Tom!..."

Vëlla i paharruar! Zemra jote e bardhëna la mesazhin: "Ruajeni përzemërsinë! Largojeni përçarjet! Forconi bashkimin!"... Siç pate shpirtin, ashtu të gjithëve na ke këtu në Brukselin e largët... Temja me motrën Prenushë dhe me të gjithë nipërit e mbesat që mungojnë"...

Pastaj nën tingujt e këngës së Flamurit u përcoll ky bir i tokës shqiptare, ky oficer i lartë, veteran i Ushtrisë për në banesën e fundit.

Jeta etij qe një sfidë për lirinë, për mbrojtjen kombëtare, për familjen që e deshi me aq përkushtim, për miqtë e shokët që nuk do t'i harroj kurrë as në përjetësi dhe ata do ta mbartin me vete, në këtë jetë dhe në të gjitha jetët e tjera si një rekuem malli e dashurie të pashuar...

AKTUALITET

Përfundimi i fazës së parë të këtij projekti sjell përmirësim të rëndësishëm të situatës së sigurisë për popullsinë dhe ambientin

Përmbillet me sukses projekti i ripaketimit të lëndëve kimike

Ambasadori i OSBE Rauning theksoi se ky projekt, me planifikimin, zbatimin dhe rezultatet e tij, përbën një shembull të besimit reciprok dhe bashkëpunimit efektiv midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe prezencës së OSBE në Tiranë

Në repartin ushtarak në Qafë Mollë, më 20 nëntor 2013 është zhvilluar një ceremoni me rastin e përfundimit me sukses të fazës së parë të projektit të ripaketimit të lëndëve kimike.

Në këtë ceremoni ishte e pranishme ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, ambasadori i OSBE në Tiranë, z. Florian Rauning, ambasadori i Republikës Çeke, z. Bronislava Tomasova, ambasadori i Spanjës, z. Rafael Tormo Perez, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Viktor Berdo, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të Zyrës së CUBIC, si dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli në fjalën e saj, pasi ka falënderuar personelin që ka punuar për realizimin e këtij projekti, theksoi se, realizimi i projektit shënon një arritje tjetër në bashkëpunimin e frytshëm midis OSBE dhe Ministrisë së Mbrojtjes, bashkëpunim i cili ka filluar vite më parë. Duke folur më tej mbi rëndësinë e këtij projekti, ministrja Kodheli u shpreh se, në më pak se dy muaj OSBE dhe Ministria e Mbrojtjes përfunduan projektin, i cili synonte ripaketimin e materialeve të rrezikshme të gjendura në vende të ndryshme, si në Shkozë, Poliçan, Laboratorin Ushtarak në Tiranë, Gramsh, Elbasan dhe Qafë Mollë.

"Këto produkte të rrezikshme, në një sasi rreth 100 ton, që nuk i përkasin vetëm FA, janë ripaketuar në përputhje të plotë me standardet ndërkombehtarë dhe janë të sigurta për t'u eksportuar dhe shkatërruar", - është shprehur ministrja Kodheli.

Në vijim, znj. Kodheli nënvizoi faktin se përfundimi i fazës së parë të këtij projekti, veçanërisht në një moment ku opinioni publik shqiptar është më sensitiv ndaj kimikateve të rrezikshme, sjell përmirësim të rëndësishëm të situatës së sigurisë për popullsinë dhe ambientin. Me këtë rast, ajo ka shprehur një falënderim dhe mirënjohje të veçantë për ndihmën e dhënë nga vendet mike gjatë gjithë këtij procesi shumë të vështirë si: SHBA, Kanada, Zvicra, Republika Çeke, Turqia, Danimarka, Holanda, Finlanda, Gjermania, Greqia, Italia, Suedia dhe prezencën e OSBE në Shqipëri.

Më tej, ministrja Kodheli theksoi se eliminimi i municioneve të tepërta dhe armatimeve, eliminimi i sasive të konsiderueshme të kimikateve të rrezikshme, si dhe i qindra ton materialeve logjistike të panevojshme për FA vazhdon të jetë një prioritet i rëndësishëm i Ministrisë së Mbrojtjes, duke nënvizuar se, pavarësisht se ndeshemi sot me një numër sfidash, ne jemi të vendosur të identifikojmë të gjitha sasi të vendndodhjen e kimikateve të rrezikshme, të cilat disponohen ende nga njësitë dhe repartet e FA dhe t'i bëjmë



Ministrja Kodheli theksoi se eliminimi i municioneve të tepërta dhe armatimeve, eliminimi i sasive të konsiderueshme të kimikateve të rrezikshme, si dhe i qindra ton materialeve logjistike të panevojshme për FA vazhdon të jetë një prioritet i rëndësishëm i Ministrisë së Mbrojtjes, duke nënvizuar se, pavarësisht se ndeshemi sot me një numër sfidash, ne jemi të vendosur të identifikojmë të gjitha sasi të vendndodhjen e kimikateve të rrezikshme, të cilat disponohen ende nga njësitë dhe repartet e FA dhe t'i bëjmë ato gati për t'i përfshirë në projekte të tjera eliminimi

ato gati për t'i përfshirë në projekte të tjera eliminimi.

Ndërsa ambasadori i OSBE Rauning theksoi se ky projekt, me planifikimin, zbatimin dhe rezultatet e tij, përbën një shembull të besimit reciprok dhe bashkëpunimit efektiv midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe prezencës së OSBE në Tiranë. Por, theksoi ai më tej, ky është vetëm hapi i parë, ne duhet të gjejmë një zgjidhje

për shkatërrimin e këtyre kimikateve. "Aktualisht OSBE po kërkon një fond shtesë prej 250 mijë euro për t'i transportuar kimikatet tashmë të paketuara në mënyrë të sigurtë për t'u shkatërruar në impiantet e asgjësimit të kimikateve jashtë Shqipërisë. Këtë javë, disa ekspertë nga Vjena do të vijnë në Shqipëri për të ndihmuar që të përgatisim fazën e dytë të projektit", - është shprehur ambasadori Rauning.

Ministrja Kodheli, e shoqëruar nga ambasadorët dhe ushtarakët e lartë të FA, inspektuan nga afër mjediset e repartit dhe kontejnerët ku janë vendosur të paketuara lëndët kimike, ndërsa në përfundim të kësaj ceremonie ministrja Kodheli shpërndau certifikata vlerësimi për punonjësit që janë përfshirë në realizimin e këtij projekti.

Haxhi Rumi, partizani trim i Brigadës së II-të S

Më 28 Nëntor u mbushën 70 vjet nga krijimi i Brigadës së II-të Sulmuese. Ajo u formua në fshatin Skrep të Shëngjergjit në rrethin e Tiranës. Partizanët e kësaj brigade, me komandant Beqir Ballukun dhe komisar Vasil Konomin luftuan me armë të dorë kundër pushtuesve fashistë italianë e nazistë gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, deri në çlirimin e plotë të atdheut. Brenda pak kohësh efektiv i saj u dyfishua (nga 600 në 1400 partizanë).

Një ndër 1400 partizanët e Brigadës së II-të Sulmuese ishte edhe Haxhi Mehmet Rumi, lindur më 1921 në fshatin Gostivisht, Ersekë. Ai vinte në këtë brigadë nga batalioni "Hakmarrja", ku

ishte dalluar për trimëri dhe për zgjuarsitë të rrallë. Rridhte nga një familje patriotike, e cila që në fillim e përkahu Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe u bë baze e Luftës.

Në brigadën e Dytë, Haxhiu mori pjesë në të gjitha aksionet e luftimit deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Për meritat e tij në luftë, Haxhiu ishte dekoruar me disa Urdhëra e Medalje. Mbi të gjitha ai mbante Medaljet e Trimërisë, Çlirimit dhe Kujtimit.

Ai nuk e harroi kurrë luftën dhe ishte krenar si një ndër 1400 partizanët e kësaj brigade.

Haxhi Mehmet Rumi mbajti me nder deri në fund të jetës së tij Statusin e Veteranit të LANÇ. Sa që gjallë punoi me përkushtim për

transmetimin e vlerave të Luftës Nacionalçlirimtare tek brezat e rinj. Ai ishte një intelektual i zoti, i dashur dhe i respektuar në familje dhe shoqëri.

Ai u nda nga jeta aksidentalisht më 19 gusht të vitit 2009. Vajza e tij, Begzadeja krenohet për jetën dhe veprën e babait të saj, ashtu siç krenohen dhe nipërit e mbesat.

Veterani Haxhi Rumi përkujtohet me nderim e respekt të veçantë nga familja, të afërmit dhe miqtë e shokët e shumtë në Kolonjë, Korçë e Tiranë.

Lavdi Brigadës së II-të Sulmuese!

I përjetshëm kujtimi i veteranit Haxhi Rumi.

Skënder RUMI



PROMOVIMI

U përrua monografia e Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës

"KRAH I LUFTËS PËR ÇLIRIM, PAVARËSI, VETËVENDOSJE E SHTETËSI TË KOSOVËS NË VITET 1990-2012"

Të shtunën, më 9 nëntor, në sallën solemne të Pallatit të Kulturës "Asim Vokshi" në Gjakovë u bë përrimi i librit të Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës "Krah i luftës për çlirim, pavarësi, vetëvendosje e shtetësi të Kosovës në vitet 1990-2012". Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, Vehap Shita, sajues dhe redaktor i librit, kurse fjalën përshëndetëse e mbajti gjeneral lejtënant Rrahman Parllaku, kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ të Popullit Shqiptar. Mandej u lexua recensionin e akademik Pajazit Nushi dhe foli akademik Jusuf Bajraktarit. Në fund, një fjalë rasti mbajti edhe Vehap Shita, shkrimtar. Me këtë rast po japim këtu pjesë të fjalëve të mbajtura në këtë tubim.

Akademik Pajazit Nushi:

Kontribut në zhvillimin e mendimit lidhor ndërmjet së kaluarës së afërt, asaj të sotmes dhe të së ardhmes në shtetformimin e shtetndërtimin e Kosovës

Vepra "Krah i luftës për çlirim, pavarësi, vetëvendosje e shtetësi të Kosovës në vitet 1990-2012" - thotë në recensionin e tij akademik Pajazit Nushi - bën pjesë në literaturën e zhvillimit të mendimit politik, historik e kulturor të shqiptarëve në vitet e dekadës së fundit të shekullit njëzet dhe në dymbëdhjetë vjetet e parë të shekullit njëzetënjë. Kumtesat, deklaratat, reagimet, protestat, apelet, nderimi i heronjve dhe i dëshmorëve të LANÇ të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit në tribuna përkujtimesh dhe në tubime shkencore tregojnë karakterin e subjektit të zhvillimeve politike çlirimtare të shqiptarëve të Kosovës së atyre viteve të rënda shtypëse nga politika e institucionalizuar armiqësore e organeve dhe e institucioneve të Serbisë ndaj Kosovës, përkatësisht ndaj shqiptarëve.

Në këtë pikëpamje, kjo veprë paraqet kontribut në zhvillimin e mendimit lidhor ndërmjet së kaluarës së afërt, të asaj të sotmes dhe të së ardhmes në shtetformimin e shtetndërtimin e Kosovës. Nga ky këndvështrim mund të thuhet se përmbajtja e kësaj veprë është manifestim i vetëdijes së shqiptarëve të këtyre dy dekadave në kapërcyell prej viteve të dëbimit, të vrasjeve, të dhunimeve, të asgjësimit të pronave shtëpiake e kolektive të shqiptarëve në vitin e fitores ndaj pushtuesit serb dhe në marrjen pjesë aktive në zhvillimin e proceseve lirishtetëse e demokratike të Kosovës pluraliste dhe demokratike. Këtë e dëshmojnë apelet, deklaratat, kumtesat, protestat, reagimet e kësaj Shoqate si dhe trajtesat profesionale dhe shkencore për lëvizjen çlirimtare të antifashistëve shqiptarë, për heronjtë dhe dëshmorët e kësaj lëvizjeje dhe të Luftës Nacional-Çlirimtare,

inkuadrimit e kësaj lëvizjeje dhe lufte në frontin e përbashkët antifashist të Evropës lirishtetëse.

E gjithë kjo për Kosovën e vogël e të prapambetur të atyre viteve nuk ka qenë pak. Tmerret, burgimi, vrasjet dhe gjaku i derdhur i bijve më të mirë të Kosovës kanë bërë që antifashistët shqiptarë të bëhen krah i lëvizjes për çlirimin e Kosovës dhe të renditen në frontin e luftës çlirimtare kundër nazi-fashizmit, përkatësisht në frontin e fituesve të Luftës II Botërore.

Ky ka qenë burimi kryesor i motivacionit dhe i angazhimit të veteranëve të asaj lufte në një subjekt politik, tashmë të njohur, me emërtimin Shoqata e Veteranëve të Luftës Nacional-Çlirimtare të Kosovës. Mjafton të përmendet qëndrimi universal i Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të shpallur me rastin e pesëdhjetë vjetorit të ngadhënjimit mbi fashizmin - Ditës së Fitores, përkatësisht Ditës së Evropës, ku është thënë: "Edhe pse të shtyrë në moshë, do ta japim ndihmesën tonë për liri, vetëvendosje dhe pavarësi të popullit tonë" ose deklaratën e njërit nga themeluesit e kësaj Shoqate, të ndjerit Fadil Hoxha, për të kuptuar esencën programore të veprimtarisë së kësaj Shoqate dhe aspiratat lirishtetëse të saj, kur ka thënë: "Sikur të isha i ri edhe një herë do ta merrja pushkën në krah dhe do t'i bashkohesha Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

Vepra në fjalë, sa ka karakter publicistik e dokumentar, aq mund të thuhet se ka edhe përmasë monografie specifike, sepse trajton gjenezën e veprimtarisë së kësaj Shoqate dhe shumëllojshmërinë tematike të aktivitetit të saj dhe të anëtarëve të saj. Në panoramën e zhvillimit të vetëdijes kulturore të shqiptarëve të viteve kur është themeluar (1990) dhe vepron kjo Shoqatë, kjo veprë gjithësesi zë vend të veçantë me përmasë studimore, sepse u shërben studiuesve të mendimit politik të periudhës së veprimtarisë së saj si burim faktesh e të dhënash për të vlerësuar gjithanshmërisht karakteristikat e mendimit politik të kësaj periudhe kohore dhe aspektin humanist të mendimit dhe të aktivitetit të anëtarëve të saj.

Redaktori dhe redaksia e kësaj veprë i janë qasur më mirë tërësisë së aktiviteteve të nduarnduarshme. Përmbajtja e veprës është shkruar me dituri dhe plotëson disa boshllëqe për të kaluarën dhe qartëson hollësitë e aspekteve të Lëvizjes dhe të Luftës Nacional - Çlirimtare të shqiptarëve përgjithësisht dhe të shqiptarëve të Kosovës posaçërisht, si dhe synimet e aktivitetit të Shoqatës në të ardhmen. Më në fund me leximin e kësaj veprë do të dimë më shumë për



vetveten dhe angazhimin e veteranëve të LANÇ prej një stadi emancipues në stadin më të lartë të shtetit anticipues të së ardhmes evropiane dhe të bashkimit kombëtar të shqiptarëve.

Shtirja dhe struktura e përmbajtjes së veprës

Përmbajtja e veprës është e shtrirë në 703 faqe. Përmbajtja e saj është e ndarë në dy pjesë: 1. Libri i Parë dhe 2. Libri i dytë. Në pjesën e librit të parë janë sistemuar aktivitetet e Shoqatës prej fillësive të veprimtarisë, përkatësisht prej vitit 1900 deri në vitin 1999. Pjesa e dytë ka më shumë se 2/3 e gjithë librit. Në këtë pjesë ka shkrime të shumëllojshme që i kushtohen Frymës dhe traditave të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të Kosovës. Tërë përmbajtja e librit është përpunuar dhe mbarështuar në mënyrë kronologjike duke filluar nga hapat e parë të Shoqatës në vitin 1990 deri në aktivitetet e fundit të shënimit të pesë vjetorit të pavarësisë së Kosovës në vitin 2013. Përbrenda tekstit dallojmë: anekse, artikuj, apele, deklaratat, evokime, fjalë falënderimi, informata, in memoriam, intervista, komunikata, kujtesë e kumtesë, kumtesa, letra, njoftime për media, opinione, programe, recensione, referate, rikujtime, statuti, shënime, telegrame dhe vështrime. Këto përbëjnë njëzet e tri lloje shkrimesh e përmbajtjesh ndër më të ndryshmet. Vështrirë është përcaktimi i një pari-

mi klasifikues i këtyre përmbajtjeve të shumëllojshme, ku secila ka rëndësinë dhe vlerat e veta. Megjithëkëtë, këto pjesë të përmbajtjes së kësaj veprë, përpos shtrirjes kronologjike që e përmendëm, kanë edhe veçori të përbashkëta.

Akademik Jusuf Bajraktari:

Libër me vlera të posaçme për të kaluarën tonë të afërt

Në vazhden e botimeve kushtuar figurave kombëtare e ngjarjeve që ndërlidhen me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe me pesë vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, përmbledhja e punimeve në formë monografie mbi aktivitetet e Shoqatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës si dhe të organizimeve të institucioneve të ndryshme të Kosovës për nder të LANÇ dhe pjesëmarrësve të saj është një libër me vlera të posaçme për të kaluarën tonë të afërt.

Kjo përmbledhje gërsheton në vete materiale dhe të dhëna mjaft interesante në përpjekjet për të ndriçuar dhe respektuar luftën e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera kundër pushtuesve nazifashistë. Në librin e parë lexuesi mund të gjejë frymën e Shoqatës së Veteranëve të LANÇ në Kosovë, e cila është manifestuar përmes kumtesave, deklaratave, reagimeve, protestave, apeleve, lutjeve, kërkesave e thirrjeve për çlirim, vetëvendosje e bashkim kombëtar... Në

këtë pjesë spikasin artikuj mbi kontributin e Fadil Hoxhës në aktivitetet e Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës në vitet 1997-2001, mbi të drejtën për vetëvendosjen e shqiptarëve në kuadër të Jugosllavisë, mbi reagimin ndaj Kryesisë, Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv të RSFJ lidhur me diskriminimin dhe suprimimin e të drejtave të shqiptarëve...

Në këtë pjesë veçohet edhe intervista me Fadil Hoxhën, e realizuar nga publicisti i mirënjohur Blendin Fevziu në vitin 1998, në të cilën shpalosen detaje interesante për jetën e veprën e Fadil Hoxhës dhe qëndrimet e tij mbi të kaluarën, sidomos në periudhën e Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj.

"... pa njohjen e të drejtës së vetëvendosjes së popullit tonë paqë e siguri në Ballkan nuk do të ketë".

Megjithëse çdo element, që e përbën këtë pjesë, bart me vete edhe peshën e vlerën që ka, për t'u veçuar janë edhe apelet e veteranëve shqiptarë të LANÇ të Kosovës drejtuar forcave demokratike të Evropës (1995), Këshillit të Sigurimit dhe Sekretarëve të Përgjithshëm të OKB-s, z. Butros Gali e Kofi Anan (1996) përmes të cilave u kërkohej këtyre organizimave ndërkombëtarë të ndih-



Shenime rreth monografise per periudhen 1990-2012

22 VJET VEPRIMTARI FRUTDHENESE E SHOQATES SE VETERANEVE TE LUFTES ANTIFASHISTE NACIONAL ÇLIRIMTARE TE KOSOVES

Nga Rrahman PARLLAKU*


Është një nder dhe kënaqësi e veçantë për mua, që në emër të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës së Shqipërisë t'ju uroj për punën e madhe që keni bërë në këto vite, punë që pasqyrohet më së miri në këtë monografi voluminoze dhe të përgatitur me seriozitet dhe nivel të lartë.

Kjo monografi publikohet në 100 vjetorin e shtetit shqiptar dhe në 5 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës.

Në dallim nga popullsia e Shqipërisë, populli i Kosovës në këto 100 vjet zhvilloi dy luftëra, luftën Nacional Çlirimtare në kuadrin e Luftës së II Botërore dhe Luftën për pavarësi, vetëvendosje dhe shtetësi të Kosovës.

Unë që i përkas periudhave të dy luftërave nuk gjej fjalë për të falenderuar brezin e Luftës së II Botërore që u renditën me fitimtarët dhe brezin e ri, të atyre që luftuan dhe fituan lirinë e munguar, pavarësinë e dëshiruar e të shumëpritur, të luftëtarëve të UÇK.

Çdo kohë ka vlerat e saj dhe luftëtarët e saj. Pa luftën Nacional Çlirimtare në Shqipëri dhe në Kosovë, ndonëse atëhere nuk u realizua ëndrra e bashkimit të shqiptarëve, u realizua autonomia e Kosovës dhe ruajtja e tërësisë territoriale të Sh-



qipërisë, dy baza të fuqishme këto për të mos ja filluar nga hiçi, por nga dy themele bashkimi. Mbi këto themele u hodhën shumë ujë dhe lëndë shkatërruese, por qëndresa heroike e shqiptarëve si në Kosovë dhe në Shqipëri bëri të mundur që sot të kemi Shqipërinë anëtare të NATO - s dhe kandidate për në

Bashkimin Europian dhe Kosovën të lirë, të pavarur dhe demokratike.

Nuk ka gjetje më të mirë për hapjen e librit e librit monografik se sa thënia e Fadil Hoxhës në një intervistë dhënë gazetarit Blendi Fevziu në Televizionin KLAN dhe në KOHA DITORE në dhjetor 1998 se pa çlirimin e shqiptarëve

të Kosovës nuk do të ketë qetësi në këto anë, madje as në Jugosllavi, as në Shqipëri dhe as në Ballkan.

Luftëtarët shqiptarë në mbarim të Luftës së II Botërore nuk arritën ta bashkonin Shqipërinë me Kosovën, por bënë Konferencën e Bujanit, bënë atë që kishin më të çmuar, dhanë jetën e tyre për atdhe.

Luftëtarët kosovarë e çuan deri në fund dëshirën dhe amanetin e të parëve, fituan lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. UÇK pati rolin vendimtar në këtë luftë, por pa mohuar rolin e SHBA dhe të NATOs.

U gjenda në krye të një grupi ushtarakësh veteranë të Shqipërisë në ato ditë lufte të UÇK për të dhënë kontributin tonë ndonëse në moshë të thyer sepse lufta për mbrojtjen e trojeve tona shqiptare nuk njih moshë.

Në këtë monografi që është por si një ditar lufte gjeta shokët, gjeta bijtë e shokëve, të veteranëve, në disa fjalime mortore tingëllonin akoma krismat e armëve. U rinova në ditën e fitores në qershorin e vitit 1999, por edhe më shumë u gëzoja në ditën e pavarësisë më 17 shkurt.

Në këtë libër vihet re me kënaqësi thënia e të vërtetave dhe shmangja nga subjektivizmat politikë. Luftën e bëjnë luftëtarët dhe

historinë e shkruajnë po luftëtarët sepse ata e shkruajnë me gjak. Historianët duhet ti interpretojnë mirë faktet në kohën dhe vendin e duhur sepse sa më shumë kalon koha dhe aktorët e autorët vdesin, aq shumë shtohet rreziku i subjektivizmit historik, sepse në skenë dalin figurat e reja politike që kërkojnë edhe lavdinë e pamerituar.

Kjo ka ndodhur si në Shqipëri dhe në Kosovë, ka ndodhur errësimi, ashtu siç ka ndodhur glorifikimi i personazheve dhe ngjarjeve të luftës. Dhe këtë nuk duhet ta lejojë Organizata e Veteranëve të Luftës. Por dalja në dritë e e librave të tillë si historiku i Shoqatës së Veteranëve të Kosovës 1990-2012 është një kontribut madhor historik dhe parandalon shtrmbërimet që përmenda më lart.

Tani Shoqata e Veteranëve të Luftës së Kosovës ka në krye një njeri të luftës dhe të letrave. Duke i uruar zgjedhjen në krye të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Kosovës mikut tim Vehap Shita ju uroj gjithë veteranëve të Kosovës shëndet dhe veprimtari të dobishme në të mirë të çështjes së shenjtë kombëtare.

*Fjala e Kryetarit të OBVL-së në promovimin e monografisë "Krah i luftës për çlirim, pavarësi, vetëvendosje e shtetësi të Kosovës në vitet 1990-2012"



monin popullin shqiptar të Kosovës për lirinë dhe pavarësinë e tij. Në to, ndër të tjera, thuhej se "... pa njohjen e të drejtës së vetëvendosjes së popullit tonë paqe e siguri në Ballkan nuk do të ketë".

Shoqata e Veteranëve të LANÇ në Kosovë u tregua mjaft aktive edhe në kohën e dhunës, të terrorit më të madh dhe të gjenocidit serb mbi shqiptarët e Kosovës në vitet 1997-1999. Kjo shoqatë nuk pushoi së reaguari e dënuari akte të tilla antinjerëzore, duke u bërë thirrje institucioneve ndërkombëtare, OKB-së, OSBE-së, Bashkimit Evropian e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që të ndërpriten dhuna në Kosovë...

Me çlirimin e Kosovës nga pushteti ushtarako-policor serb në qershor të vitit 1999, Shoqata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës reagoi ndaj çështjeve të pazgjidhura si problemi i ndarjes së Kosovës, përkatësisht Mitrovicës dhe çështje të tjera sociale.

Shoqata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës ndoqi me shumë vëmendje zhvillimet politike në Kosovë, duke qenë e vendosur në zgjidhjen e drejtë të statusit politik të saj, pra pavarësinë. Për të Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 është një akt që do të çojë vendin tonë drejt integritetit në Bashkimin Evropian dhe mekanizmave të tjerë euroatlantikë, duke u realizuar kështu aspirata shekullore e shqiptarëve për liri e bash-

kim kombëtar.

Ajo që e veçon dhe begaton këtë pjesë është një mozaik i pasur me të dhëna relevante mbi jetën dhe veprën e figurave të shquara të Luftës Antifashiste në Kosovë si: Mustafa Bakia, Asim Efendi Luzha, Zekeria Rexha, Qamil Hoxha, Ali Rexha, Xhevdet Pula, Fadil Hoxha, Sadik Tafarshiku, Sabrije - Bije, Dergut, Myftar e Xhafer Vokshi, Ramiz Sadiku, Ali Kelmendi, Emin Duraku, Hajdar Dushi, Meto Bajraktari, Ymer Pula, Xhevdet Doda, Ramadan Vraniqi, Xhevdet Hamza, Velid Dedi, Muharrem Bekteshi, Abdullah Presheva, Zeqë Vërbani, Ymer Jaka etj.

Përpos përkujtimin dhe nderimit të figurave dhe ruajtjes së vlerave të saj, dy elemente që gërshetojnë njëra-tjetrën në këtë përmbledhje shkrimesh janë Konferenca e Bujanit, si gur themeltar për mëvetësinë e Kosovës dhe Fadil Hoxha si personalitet historik në gjysmën e dytë të shek. XX në luftën për çlirim e vetëvendosje, ndërtim e shtetformim të Kosovës.

Përmbledhja në mënyrë kronologjike e këtyre aktiviteteve të veprimtarisë së Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës përbën një dokument të rëndësishëm të mishëruar me zhvillimet politike në Kosovë në dy dekadat e fundit dhe më gjerë, në të cilat kjo Shoqatë dha kontributin e saj të çmuar. Vepra në fjalë mbështetet në argumente të bollshme dhe të sistemuara me kujdes. Ajo përpunohet e ndërthurur mirë në një vëllim të ngjeshur dhe të ilustruar me dëshmi

konkrete. Trajtimi i materies themelore në aspektin metodologjik paraqet një rrjedhë kronologjike shumë të përshatshme...

Qasja objektive, analitike dhe kritike e burimeve përmes interpretimeve vetjake për ngjarjet dhe protagonistët kryesorë të Luftës së Dytë Botërore dhe më pas, jo vetëm që tentohet të rrumbullakohet me anë të prurjeve të reja, por njëkohësisht qartësohet, rivendoset e zgjerohet horizonti i njohurive për rëndësinë e LANÇ në Kosovë dhe ngjarjet pas LDB, ku fuqizohet dëshmia e provave për padrejtësitë që u janë bërë shqiptarëve të Kosovës në rrugën e përgjakshme për liri, pavarësi dhe demokraci.

Duke pasur në konsideratë konstatimet e mësipërme, vlerësojmë se për përgatitjen e një monografie të tillë është dashur mund, dije dhe përpjekje këmbëngulëse për ta hartuar e prezantuar para opinionit lexues në mënyrë që të zgjonte kureshtjen e tij dhe të mirëpritet në rrethe publicistike dhe shkencore. Prandaj, me përzemërsi uroj Shoqatën e Veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe anëtarët e saj të nderuar për punën e tyre të vlefshme. Në veçanti përgëzoj z. Vehap Shita, nën përkujdesjen e të cilit ky botim po e sheh dritën. Në fund dua të them se monografia që sot po përurohet ka edhe një dimension praktik, i cili manifestohet në faktin e një kontributi të mirëfilltë nga autorë të çmuar me përvojë të begatë në fushën e literaturës siç janë Vehap Shita, akademik Pajazit Nushi e shumë autorë të tjerë

Vehap Shita, shkrimtar:

Identiteti e jo verifikimi i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

Shkrimet në këtë libër nuk janë komente. Ato janë dokumente të mbledhura e të tubuara këtu. Ato janë letra, thirrje, protesta, kumtesa për ngjarjet në Kosovë, për Kosovën nën okupacion të hapur. Të gjitha publike, të drejtuara instancave më të larta të vendit dhe të botës, duke filluar nga ato në Kosovë e ish-Jugosllavi, deri tek ato të bashkësisë ndërkombëtare: Organizatës së Kombeve të Bashkuara e Këshillit të Sigurimit, Organizatës për Siguri e Bashkëpunim Evropian, sekretarëve të përgjithshëm të OKB e të Këshillit të Sigurimit e deri tek organizatat humanitare ndërkombëtare. Të gjitha këto i janë dërguar botës me letra e postë elektronike e janë të ruajtura në arkivin e Shoqatës sonë - të prezantuar kronologjikisht në këtë libër, krahas materialeve që kanë shkruar bashkëpunëtorët tanë për tubimet tona përkujtimore, përuruese, mbledhje e konsulta. Janë dhënë këtu pasi janë lëshuar në opinion. Janë dhënë të grumbulluara në një vend për të identifikuar identitetin e Lëvizjes sonë Antifashiste Nacionalçlirimtare, për të njohur e kultivuar traditat çlirimtare të popullit tonë. Për të identifikuar një lëvizje e një luftë e jo për të verifikuar apo arsyetuar dikë apo diçka. Të gjitha të bëmat e të pabëmat flasin vetë. Libri ynë reflekton veprimtarinë e gjeneratës, të cilës i takoi të luftojë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj të

kalojë edhe periudhën e riokupimit serb dhe luftën për dëbimin definitiv të forcave okupuese ushtarako-policeore e paramilitare serbe. Libri që kemi në dorë i reflekton të gjitha këto dhe përpjekjet më se dyzet vjeçare në ndërtim e rindërtim, shkollim e arsimim, ngritje e zhvillim dhe, së bashku me gjeneratat që pasuan, përkundër shumë sfidave, të natyrave nga më të ndryshmet, që përballuan, ta mbajnë gjallë, ta avancojnë luftën për çlirim, liri e pavarësi, vetëvendosje, shtetformim e shtetësi, për Kosovën - subjekt i pavarur e sovran.

Librin ia kemi kushtuar 100-vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar dhe 5-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Me përurimin e këtij libri në Prishtinë, Gjakovë, Gjiilan e qendra të tjera të Kosovës, e pas pak edhe në Tiranë, Shkodër e ndonjë qendër tjetër të Shqipërisë e shënojmë edhe 70-Vjetorin e Konferencës së Bujanit, në të cilën, në territorin e çliruar në Malësinë e Gjakovës, në territorin e Shtetit Shqiptar, me praninë përfaqësuesve të Misionit Ushtarak të Bllokut Antifashist Ndërkombëtar e të ushtrive nacionalçlirimtare të Shqipërisë e të Kosovës u miratua Rezoluta historike me të cilën popullit shqiptar të Kosovës i njihet e drejta për vetëvendosje e bashkim kombëtar me Shqipërinë - shtet i njohur ndërkombëtarisht si shtet i kombit shqiptar, e drejtë kjo për të cilën kanë luftuar edhe shumë gjenerata të kombit tonë para e pas nesh.

PROMOVIMI

Promovimi i LIBRIT, në kuadrin e ditës "Sofra Pukjane"

PROMOVOHET ME SUKSES BOTIMI "POETI I MALËSISË"

Ë shtë viti i gjashtë i shoqatës së biznesmenëve "Sofra Pukjane" me president të kësaj shoqate, juristin Arian Ndoj. Në këtë vit të gjashtë të veprimtarisë së kësaj shoqate, ndryshe prej viteve të tjera, iu bë një shtesë programit që zbatohet zakonisht më parë. Koncertit të "Ansambllit Puka" që hapte programin çdo vit, kësaj here i parapriu promovimi i botimit të përmbledhës së poezive të rapsodit Prendush Gega, "Artist i Merituar".

Masat përgatitore ishin marrë me kohë si e ka traditë Puka, sidomos Xhemal Meçi, autori i librit dhe njëherit përgjegjës i Muzeut Historik të Pukës. Erdhi në Tiranë një javë para veprimtarisë promovuese: përfundoi ftesat në shtypshkronjën GEER dhe, si na i dorëzoi mua dhe kolonel Bilbil Dervishit, së bashku shkuam e porositëm një poster promovimi 2'5 m e gjatë me 1'5 m e gjërë, e para e këtij lloji, që u përdor në Pukë më 3 nëntor. Në plan të parë të posterit dilte kopertina e bukur e librit: Shqipëria Etnike apo Natyrale, bojëkuqe, bojëgjaku, e çarë me kufij pesë shtetesh. Në krah, ngjitur saj si lapidar, rapsodi i "Alpeve Shqiptare", me kushtrimin në gojë: "Dajn Shqipninë copa-copa". ("Vinë pesë krajlaj neper det! Vin pesë krajlaj qi çoi Europa./ Dajn Shqipninë copa-copa!")

Promovimi, organizim i Qendrës Kulturore Pukë në bashkëpunim me shoqatën "Sofra Pukjane", u mirëprit prej një auditori intelektualësh të moshave të ndryshme, si edhe veteranësh me n/kryetarët: Zekë Curri dhe Ramadan Shkrelit. Për nderim dhe respekt kishin ardhë profesorë e studiues të mirënjohur nga Shkodra e Tirana, si edhe deputeti i Parlamentit Shqiptar, Mark Frroku, ish-nxënësi i autorit, 30 vjet më parë, në Shkollën "Ndue Jak Pjetri" Luf dhe e kishte për respekt ta kujtonte mësuesin e tij, tani kur po e përshëndeste për botimin për një prej rapsodëve me përmasa kombëtare me vlera për Pukën.

Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i Bashkisë Pukë, Beqir Arifaj i cili falënderoi të ftuarit dhe vlerësoi këtë botim të vlerave të traditës së fjalës artistike, të shprehura në këngët e rapsodit të shquar me përmasa mbarëkombëtare. Meritë për këtë botim të kësaj përmbledhëse tha se "ka autori Xhemal Meçi, "Mjeshtër i Madh", i cili ka 45 vjet që hulumton nëpër Pukë, Mirditë, Tropojë, Kukës, Nënshkodër, Lezhë e tjerë."

Profesorë dhe studiues për vlerat e librit e TË autorit

Prof. dok. Agron Xhagolli, nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe të Studimit të Artit, Qendra e Studimeve Albanologjike Tiranë, mbajti referatin: "Prendush Gega, Artist i Merituar, Poeti i Malësisë - Figurë Emblematike e letërsisë gojore artistike shqiptare", ku shpalosi me argumente shkencore punën e

gjatë e me përkushtim të autorit Xhemal Meçi, "Mjeshtër i madh", që hulumtoi, mbledhi, sistemoi dhe botoi ato mijëra vargje poetike të atij rapsodi që sillet tani para lexuesve dhe studiuesve me tërë madhësinë e vlerave artistike dhe etnohistorike.

"Për sa i përket struktursë së librit, vazhdon Prof. dok. Agron Xhagolli, duhet pohuar se autori ka sjellë në të edhe disa mendime apo vlerësime të dhëna nga studiues apo personalitete të ndryshëm, si dhe letërkëmbimin në vite që Xhemali ka pasë me drejtues dhe punonjës institucionesh të ndryshme për sa i përket punës për ndriçimin sa më të plotë të ndihmesës së Prendush Gegës në kulturën popullore shqiptare.

E gjithë kjo punë e kryer nga Xhemal Meçi me përkushtim, me aftësi dhe dashuri, e shtrirë në shumë vite, paraqitet e plotë si një ndihmesë e veçantë edhe në folkloristikën shqiptare. Ajo do të shërbejë, jo vetëm për të njohur plotësisht atë krijimtari që na përcjellë krijimtaria kolektive, mbi bazën e fillës individualitete të një krijuesi të lindur, siç ishte Prendush Gega, por do të mund të shërbejë si një pikë referimi për të parë konkretisht rrugën se si lindin dhe përfshihen në qarkullimin folklorik krijime të caktuara."

Profesor dok. A. Xhagolli theksoi edhe faktin se Xh. Meçi ka një vazhdimësi pune hulumtuese e studiuese mbi 40-vjeçare, ku "Pikërisht puna që realizoi Xhemali në ato vite, e në disa vite të tjera më pas në rrethet e Pukës dhe të Mirditës, rezultoi se ishte mjaft cilësore, duke e renditur ndër hulumtuesit e shquar të etnologjisë në terren. Do të mjaftonte këtu të kujtonim shfrytëzimin e materialeve të Xh. Meçit për përgatitjen e dy veprave të tij, mjaft të vlerësuara përgjithësisht nga specialistë të ndryshëm, siç janë "Kanuni i Lekë Dukagjinit, Varianti i Pukës (1996) dhe "Kanuni i Lekë Dukagjinit, Varianti i Mirditës" (2002)... Po nuk mund të mos përmend këtu edhe veprat e tjera të hartuara nga Xh. Meçi, si "Puka që në lashtësi" (2003), monografinë "Kabashi"... (2008), si dhe botime me bashkautorë, të cilët lidhen kryesisht me Pukën dhe me personalitetet të saj. Nuk kanë munguar as artikuj dhe punime të ndryshme, të botuara në shtypin e përditshëm apo në atë shkencor.

Pikërisht me punën e tij në vazhdimësi Xh. Meçi paraqitet mjaft aktiv, ka krijuar njohje dhe lidhje të shumta, vlerësime të ndryshme. Emri i tij është bërë i njohur ngado në botën shkencore shqiptare, ndaj meriton respekt e mirënjohje."

Prof. dr. Bajram Xhafa, pedagog në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në përshëndetjen e tij për autorin shprehet: "Bir i ndritur i Malësisë pukase, profesor Xh. Meçi i shtoi një tjetër gur të çmuar gjerdanit të krijimtarisë së tij: "Po-

eti i Malësisë, Prendush Gega, duke e rritë në 5 numrin e veprave seriale, një kolanë e mirënjohur nën logon: "Puka që në lashtësi", si titull serial... "Mjeshtër i Madh" Xh. Meçi kërkoi me ngulm vlera e dëshmi historike e shpirtërore, hulumtoi, mbledhi, sistemoi, studioi dhe bëri me to vepra të një niveli shkencor me vlera të paçmueshme."

Në vazhdim prof. dr. B. Xhafa thekson se rradhitën "bri shumë emrave, heronjve të këngëve të "Poetit të Kabashit": Mustafë Agë Kryeziu, Haxhi Rrustë Kabashi, Ndoc Mardeda, Mark Koliku, Zeqë Demë Kabashi, Zenel Mustafë Aga, Frrok Kolë Gjergji, Ndue Marku, Osman Hoxha, Sali Shaban Kabashi, Nikollë Curri, Sali Tahiri, Laje e Tahir Rexhep Aga etj. për të cilët janë dhënë urdhëra, medalje e tituj nderi. Nxitësi për këto dekorime dhe hartuesi kryesor i karakteristikave të veprës së tyre ka qenë Xhemal Meçi. Ka plotë dëshmorë në shumë rrethe që as çmohen, as kujtohen për atë çka ato kanë bërë për atdheun, duke dhënë jetën, por që nuk kanë as titullin "Dëshmor i Atdheut"...

Libri që promovojmë sot i mban gjallë emrat e tyre, i mban në shpirtin e popullit dhe i bënë të jehojnë fuqishëm në malet e Pukës e të Shqipërisë, se në to ka aq shumë poezi, ka shpirt malësori, ka krenari shqiptare, ka histori, ka vazhdimësi, ka amanete brezash."

Po kështu, Mentor Quku, studiues në nivele akademike, autor i kolanës "Mjeda" në 12 vëllime, nënvizon faktin se "Me këtë botim "Poeti i Malësisë" na sjell një vlerë të shquar krahas vlerave të tjera të Pukës me rëndësi kombëtare siç janë Mjeda e Gjeçovi dhe shkollën e parë shqipe të Alpeve Shqiptare në Iballe."

Sefer Pashaj, krijues dhe studiues i mirënjohur, autor i librit "Biri i Kryeziut", "Dëshmor i Atdheut", Allaman Dervishi, duke çmuar botimin me këngët e Prendush Gegës, kumton: "Mjafton edhe krijimtaria "Çika e Kocës tuj luftue" për ta vlerësuar Prendush Gegën poet të vërtetë shqiptar. Prandaj për krijimet e tij duhet hulumtuar më tej"...

Në mbyllje të këtij promovimi autori Xhemal Meçi, "Mjeshtër i Madh" falënderoi pjesëmarrësit në këtë promovim të këtij botimi me këngët e poetit rapsod Prendush Gega, "Artist i Merituar."

Ai theksoi se veprimtaria promovuese pati sukses, sepse: "së pari, ky sukses është rezultat i krijimtarisë poetike të këtij "Artisti të Merituar," të cilin, për së gjalli, të befasuar prej këngëve të tija, poezi origjinale shqiptare, e vlerësuan personalitete të letrave shqipe, duke filluar nga dom Lazer Shantoja; at Gjon Karma -" një poet i pavdekshëm"; prof. dok. Ernest Koliqi - "Poeti i Malësisë" me "këngëtoren e



vet"; kurse, Migjeni, me që e njoheu së afërmi për më se një vit, mbajti miqësi me te dhe e quajti - "Nji histori e gjallë" dhe se këngët e tija "aq të bukura, sa mund të krahasohen me poezitë ma të mira të poetëve tanë ma të mirë."

Së dyti, jeni ju me pjesëmarrjen tuaj, që me fjalët tuaja vlerësuar dhe nderuar këtë "Artist të Merituar", prandaj falënderojmë deputetin Mark Frroku i cili e quajti botimin "POETI I MALËSISË" një nder që i bëhet jo vetëm këtij rapsodi poet, por edhe mbarë Pukës, si edhe kombit mbarë. Po kështu, falënderojmë në veçanti Prof. dok. Agron Xhagolli, i Institutit të Studimeve Albanologjike, Tiranë, për ndihmesën e dhënë për trajtimin shkencor të figurës së Prendush Gegës.

Meritojnë falënderim edhe personalitetet shkencore të qytetit të Shkodrës: prof. dr. Ahmet Osja, "Mjeshtër i Madh" e "Anëtar Nderi i Akademisë së Shkencave"; prof. dr. Bajram Xhafa, Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër, i cili ka vlerësuar rolin e poezive të Prendush Gegës në pasqyrimin me vërtetësi të ngjarjeve të rëndësishme historike të viteve 1910-1913, si edhe të heronjve të këtyre ngjarjeve; studiuesi me përmasa akademike Mentor Quku, autori i mirënjohur botimesh; studiuesin e krijuesin Sefer Pashaj, autor i disa botimeve; si edhe muzikologjen Sabrije Nushi, "Krenaria e Qytetit Pukë", ish-udhëheqëse artistike e "Ansambllit Puka", 20 vjet në Radio Tirana, me nostalgji për Pukën, vendlindjen e saj, për vlerat e së cilës vazhdon t'i pasqyrojë edhe në botime. Falënderim të veçant meriton edhe studiuesi me botime serioze, Jaho Brahaj, për kumtimin e tij befasues për faktin se Fishta e paska çmuar shumë P. Gegën për këngët e kreshnikëve, Eposin Heroik,

Një falënderim i takon edhe këngëtarit: Fran Pali, reçitueseve: Denisa Meçi e Xhovana L. Prendi, mbesë e shtëpisë e Djegajve, stërmbesë e Prendush Gegës e cila po përçatit një vëllimth me krijimet e saj

adolishente. Njëkohësisht, falënderojmë të gjithë të ftuarit e tjerë nga Tirana dhe rrethe, si dhe nga bashkitë e komunat për praninë dhe mendimet e dhëna për këtë promovim bashkë me vlerësimin tim si autor për këtë botim e në vazhdim të librave të tjera në përmasa të kolanës për Pukën, që së shpejti do të arrijë në 6 botime "PUKA që në lashtësi -6".

Do të më lejoni që të mos lëmë pa falënderuar për ndihmën në të holla për këtë botim që po promovojmë, si: Ndoc Selimi -emigrant në Itali, Muhamet Kollari -arsimtar në Ulqin, Vitor Kola e Kolë Deda në Tiranë, Dedë Qafa e familjet Curri në Fushë-Arës; gjithashtu edhe sponsorët e posterit të promovimit, koktejt, Puka TV etj.: z. Mark Frroku, Ferit Rringaj, Gëzim Kopani -myftia i Pukës, Bilbil Dervishi, Ndue Gega, Vjollca Prendi, Zamir Bik Gega etj. Po kështu falënderojmë regjisorin moderator me profesionalizem Fran Vuka, "Qytetar Nderi i Pukës" dhe "Krenaria e Unionit Artistik Kombëtar Shqiptar." Njëkohësisht, falënderojmë kolonel Bilbil Dervishin, nismëtar, përkrahës dhe kordinator i promovimeve të tilla që nga Puka, Tirana dhe në Kosovë. Po kështu falënderojmë Puka Televizion me drejtor Ramazan Rringaj për ndihmesë të vazhdueshme për pasqyrimin e vlerave të Pukës.

Gjithashtu falënderojmë shoqatën "Sofra Pukjane" me president Arjan Ndojin i cili në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Bashkisë Pukë pranoi të ndihmojë për këtë promovim.

Falënderojmë edhe z. Beqir Arifaj, kryetar i Bashkisë Pukë, Nën/kryetarin e Këshillit të Qarkut Shkodër dhe kryetar i këshillit të Bashkisë Pukë për interesimin dhe organizimin e veprimtarive të tilla.

Shpresojmë se përsëri kështu edhe vitin e ardhshëm një promovim të tillë të një botimi tjetër në vazhdim të kolanës "PUKA që në lashtësi -6."

Kolë DEDA

KULTURË

Qendra kulturore e fëmijëve Pukë (QKFP - Në kuadrin e mbylljes së Muajit të Letërsisë dhe të Arteve

Trëndafila Migjeniane të krijimtarisë poetike në Pukë

Qendra kulturore e fëmijëve Pukë gjatë muajit tetor, Muaji i Letërsisë dhe i Arteve në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Bashkisë Pukë, Muzeun Historik, zhvilloi veprimtari me karakter letraroartistik, ekskursione dhe vizita në Shkollën Muze "Migjeni" Pukë.

Në kuadrin e këtyre veprimtarive, ndër të tjera, u punua edhe kjo temë me nxënësit e shkollave 9-vjeçare Pukë, Luf, Qerret dhe Qelzë, si dhe me mësues e prindër të tyre, shoqëruar me recitime prej recituesve më të mirë të këtyre shkollave dhe disa punime vizatimore të përzgjedhura që lidhen me jetën fëmijore dhe shoqërore. Gjatë gjithë veprimtarisë u kënduan këngë dhe u kërcyen valle plot gjallëri që krijuan entuziazem e hare rinore.

Një filozof që nga lashtësia tërhoqte vëmendjen: "T'i bëni fëmijët sa më të gëzueshëm, se do të bëni një vepër sa të mirë aq hyjnore."

KRIJIMTARI TË FJALËS ARTISTIKE NË PUKË

Krijimtaria e fjalës artistike vjen që nga lashtësia dhe vazhdon në shekuj deri në ditët tona. Mjaf-ton të përmendim relacionin e Frang Bardhit të qershorit të vitit 1637, ku gjatë vizitës së tij në Pukë, ndër të tjera relation se popujt e Pukës kanë doke shumë fisnike, ku veçon traditën e të kënduarit me zë të lartë trimëritë e burrave të tyre të mëdhenj, si Skëndërbeu dhe princit të tyre Lekë Dukagjini. Për më tepër këto këngë këndoheshin edhe në udhë dhe në punë. (Relacioni i Fr. Bardhit, qershor 1637, Relacione...Tiranë,1965, f. 85)

Ky fakt historik lidhet me traditën e krijimtarisë artistike të këtyre këngëve që trashëgohen në shekuj nga breza në breza të tërë, derisa shkëlqen ndër të tjerët Poeti i Malësisë, rapsodi i shquar Prendush Gega i fundshekullit XIX dhe i fillim shekullit XX (1850-1938). Për nga niveli artistik, për këngët e tia Migjeni shprehet me krenari se ato këngë " janë aq të bukura sa mund të krahasohen me poezitë ma të mira të poetëve tanë ma të mire." (Lazer Radi, "Një verë me Migjenin. Tiranë, 1998.)Prandaj studiues dhe mendimtar të shquar e kanë quajtur P. Gegën:

"Lazer Shantoja, shkrimtar, Shkodër, 1921: Poeti i Kabashit,

Ernest Koliqi, akademik, Milano, 1942: Poeti i Malësisë,

Zihni Sako, akademik, Tiranë, 1971: Një rapsod i madh,

Prof. dr. Agron Xhagolli, Tiranë, 2010: Figurë emblematike, etj.

(Xh. Meçi, Poeti i Malësisë. Tiranë, 2013, f. 7-8)

I theksuam këto për faktin se krijimtaria letrare artistike në Pukë ka një traditë në vazhdimësi që do ta gjejmë te shumë krijues gjatë gjysmës së shek. XX dhe deri në ditët tona, ku dallohen Tomë Nikolla, Frrok Haxhia, Ndrecë Mustafa, Prend Ukaj, Riza Tafilaku, Petrit Nika, Fran Vukaj, Murat Shkrejli etj.

Në këto 20 vjetët e fundit, karakteristikë e veçantë e krijuesve të letërsisë artistike është krijimtaria poetike e elementit femër, ku dallohen: Mirela Sula, Aranita Brahaj, Tone Prendi, Liza Voci, Antigona Marku, Mejreme Rringaj, Bukurie Ymeri etj.

ANTOLOGJI TË FJALËS ARTISTIKE

Prezantimin e krijuesve pukas e jep autori Riza Tafilaku në formë të përmbledhur në një antologji të titulluar " JETOJ KËTU " krijime poetike të autorëve pukas, botuar në Shkodër 2002, në 100 faqe, ku bëjnë emër: Antigona Marku me poezinë: "Nënë" dhe "Engjulli im", Aranita Brahaj me poezitë: "Enigma" e "Kush e solli Dorontinën"; Bukurie Mustafa me "Engjujt" e "Nuk di sa duar"; Etleva Delia me "S'kam kohë për"...dhe "Sytë". Vazhdon me Fran Vukën, Frrok Haxhinë, Gjon Gjoni, Merjeme Rringaj me poezitë: "Jetoj këtu", " Nëmollën e Borbardhës kafshova" dhe " Jeta fillon sërish"; Mirela Sula (Struga) me "Elvana, Ani Piterpani, Atje vonon pranvera" etj.

Në këtë antologji të autorit Riza Tafilaku është dhënë për lexuesit dhe studiuesit kritik një pasqyrë sintezë për botimin e 90 veprave, kur deri në vitin 1990 ishte botuar një vëllimth me poezi letrare të mësuesit Prend Ukaj. 19 autorët krijues mbyllën me Ton Zmalin dhe Tone Prendin. Në këtë përmblyllje le të shkëpusim poezinë kujtesë për një rini të vështirë të së kaluarës, por që, në mjaft raste, është e pranishme edhe sot, siç shpreh "Ajo vjen vetëm një here":

Ti erdhe tek unë, / Kur s' të njoha mirë,

Ti erdhe tek unë, / Kur s' të shijoja dot,

Ti erdhe dhe ike rinia ime, / Kur unë s' të ndjeva fare!

Kjo poezi intime me ndjenja përmallimi, shpreh faktin, pra, se shumë të rinj dhe të reja nga kushtet jo në nivelin e duhur, e kaluan dhe e kalojnë rininë pa ndërje dhe pa e shijuar siç do të duhej ta meritonin. Njëkohësisht është edhe një thirrje që ta çmojmë moshën e rinisë, jo vetëm si më e bukura dhe joshëse, por edhe për optimizmin e saj, për perspektivën që në rini të



shfaqet si "ora" e njeriut, si "orë e zana", që të hapin dyert e jetës. Prandaj rinia hyri edhe në betimet aq kuptimplote, aq të bukura, aq humane dhe optimiste,si

"Pasha t' Rit' e pasha Pranveren!...", sepse rinia është pranverë dhe pranvera është vet rinia. Kështu, si e tillë rinia e pranvera kanë hyrë në traditën etnokulturore të betimeve të mëdha e shumë kuptimplote: "Pasha t' Rit' e pasha Pranveren!

Për ta plotësuar më mirë kuadrin e krijuesve të rinj, le të ndalemi edhe tek një antologji tjetër, titulluar " Trandafilat e Migjenit" me autore Angjelina Paloka, Meta, botuar në Tiranë, 2010 me afro 70 krijime poetike dhe pothuaj po me kaq autorë të moshës shkollore. Këto krijime janë me interes për lexuesit sa dhe

për kritikët letrar. Ky album hapet me krijimin "Vendlindja ime" të Alvisa Llukës dhe vijon me "Puka -vendi im" të Artiola Barxhanit, "Mirëmëngjes Atdhe" të Bekim Hysenit, "Fshati im" të Kliford Gjergjit deri te "Nën dritën e Hënës" të Xhensila Pemës, "Malli për Atdhe" të Denisa Islamit, "Jeta" dhe Gentiana Struga, ku spikasin vargjet:

... "Jeta është e bukur, / edhe ka gëzime,/

Por është edhe mizore/ e na sjell trishtime.

Pra jeta është gjithçka,/ Që duhet jetuar,

Jeta është një frut / Që duhet shijuar.

Albumet të tillë kanë rëndësi për historikun e kultures dhe për

njohtjen e krijuesve pukas të fjalës artistike.

Këto dy albume, sigurisht, që kanë nevojë të pasohen me albume të tjerë duke iu referuar edhe almanakut "PUKA" 1978, botim i shëpësisë së kultures dhe krijimtarisë popullore të rrethit të Pukës, Tiranë, 1979, ku dalin në pah krijues si : Fran Pali, Jak Mema, Lumturi Kraja, Shyqyri Dunga, Ndue Filipi, Ndue Gega, Muhamet Durra etj.

Botime të kësaj natyre marrin rëndësi për faktin se krahas publikimit të krijimeve të krijuesve të rinj, shërbejnë edhe për nxitjen në vazhdim për ngritjen edhe të cilësisë të këtyre krijimeve të fjalës artistike deri në nivele poezish.

Xhemal Meçi, "Mjeshtër i Madh"

PËRVJETORI

Me rastin e 70-vjetorit të Konferencës së Parë themeluese të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës

Konferenca e Bujanit i njohu popullit të Kosovës të drejtën e vetëvendosjes

Kryesia e Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës ka vendosur që, në dhjetor të vitit 2013, ta shënojë me një Tryezë Shkencore këtë përvjetor të rëndësishëm të historisë së popullit të Kosovës e të shqiptarëve të Kosovës dhe të kombit shqiptar në përgjithësi. Këtë Konferencë do ta nderojë me prezencën e tij dhe me një fjalë përshëndetëse, kryetari i OBVL, Rrahman Parllaku gjeneral-lejtnant (në pension), Hero i Popullit.

Më 31 dhjetor 2013 bëhen 70 vjet nga dita kur në fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës, është mbajtur Konferenca themeluese e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit. Në këtë Konferencë, të mbajtur në kohën e luftës dhe në territor të çliruar, është miratuar Rezoluta me të cilën popullit të Kosovës i njihet e drejta e vetëvendosjes për fatin e vet në bazë të pjesëmarrjes aktive në Luftën Nacionalçlirimtare në anën Aleancës së Bllokut Antifashist..

Shoqata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës tërë aktivitetin e vet gjatë këtij viti e ka zhvilluar në shenjë të këtij përvjetori. Në këtë kuadër Kryesia e Shoqatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës ka vendosur që, në dhjetor të vitit 2013, ta shënojë me një Tryezë Shkencore këtë përvjetor të rëndësishëm të historisë së popullit të Kosovës e të shqiptarëve të Kosovës dhe të kombit shqiptar në përgjithësi.

Kryesia e Shoqatës të Veteranëve të LANÇ të Kosovës ka kontaktuar prof. dr. Jakup Krasniqin, kryetar i Kuvendit të Kosovës, që të marrë patronazhin e Tryezës (Konferencës) ose edhe të kërtojë manifestimin.

Ndërkohë, kjo kryesi ka kërkuar që edhe Shteti Shqiptar të marrë pjesë në ndonjë mënyrë në këtë event të rëndësishëm për kombin tonë.

Për këtë dhe për aktivitete të tjera, që mund të mbahen në shenjë të këtij përvjetori, Shoqata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës ka formuar këshillin organizativ dhe këshillin redaktues - të përkohshëm.

Është përgatitur një listë e tezave

për punimet që do të lexoheshin deri nga 10 minuta në Tryezë ose Konferencë, por që mund të jenë të punuara edhe në hapësirë më të madhe për në rast se botohen në ndonjë libër, revistë apo formë tjetër. Ndërkohë, anëtar i Këshillit Redaktues, akademik Jusuf Bajraktari, ka siguruar pjesëmarrjen e punëtorëve shkencorë të Tiranës: Prof. dr. Ana Lalaj, e cila do të paraqitej me temën: Rivlerësim për Konferencën e Bujanit; dhe akademik Marenglen Verli me temën: Konferenca e Bujanit - moment kulmor në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Ndërkaq, akademik Beqir Metaj ka deklaruar se do të vinte për të përshëndetur, por pa temë. Këtë Konferencë do ta nderojë me prezencën e tij dhe me një fjalë përshëndetëse, kryetari i OBVL, Rrahman Parllaku gjeneral-lejtnant (në pension), Hero i Popullit.



Shtëpia ku u mbajt konferenca e Bujanit

Kosova ka dëshmuar se di të menaxhojë projekte të mëdha, të cilat i ka kryer pa futur shtetin në borxh

Autostrada Morinë - Merdare, projekti më i madh i ndërmarrë ndonjëherë në Kosovë

Jahjaga: "Po përurojmë Udhën e Kombit, të ndërtuar krejtësisht me mjetet tona, që mban emrin e udhëheqësit tonë largpamës, të njeriut që e dha idenë e ndërtimit të autostradës që lidh Tiranën me Prishtinë, të presidentit të parë të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova"

Është përuar më 26.11.2013 segmenti i fundit i udhës së kombit, i cili lidh kufirin veriperëndimor të Kosovës në Merdare me bregdetin shqiptar në Adriatik.

Përkundër motit me borë, zyrtarët më të lartë të shtetit kishin shkuar në numër të madh në ceremoninë solemne, e cila u zhvillua në mes të autostradës, e cila tashmë është e hapur zyrtarisht për trafik.

Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga tha para mysafirëve se Kosova ka dëshmuar se di të menaxhojë projekte të mëdha, të cilat i ka kryer pa futur shtetin në borxh.

"Po përurojmë Udhën e Kombit, të ndërtuar krejtësisht me mjetet tona, që mban emrin e udhëheqësit tonë largpamës, të njeriut që e dha idenë e ndërtimit të autostradës që lidh Tiranën me Prishtinë, të presidentit të parë të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova", tha presidentja e Kosovës në ceremoninë solemne. Sipas presidentes Jahjaga përfundimi i këtij projekti që lidh Shqipërinë me Kosovën, dëshmoi aftësinë e institucioneve që me forca vetanake, dinë të bëjnë vepra të mëdha, që ndërli-dhin vendet, dhe mundësojnë lirinë e njerëzve e të mallrave.

Autostrada Prishtinë-Morinë, ka nisur të ndërtohet para 3 vjetësh, në



prill të vitit 2010, ndërsa ka përfunduar para afatit të parashikuar prej katër vjetësh.

Atë e ka punuar konsorciumi amerikanoturk Bechtel & Enka.

Kostoja e ndërtimit të kësaj autostrade, ka qenë arenë e përplasjeve të shumta ndërmjet të qeverisë dhe opozitës, për vite me radhë. Këtë gjë e përmendi edhe kryeministri Hashim Thaçi në fjalimin e tij gjatë ceremonisë së sotme solemne.

"Ky është projekti më i madh dhe më i shtrenjtë i ndërmarrë ndonjëherë në Kosovë, dhe presioni e kritika për të mos ndërmarrë këtë projekt, ishin jashtëzakonisht të mëdha. Por, vizioni ynë zhvillimor

fitoi mbi kritikën reaguese ditore", tha kryeministri për të shtuar më vonë se "së bashku me aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës, Adem Jashari, projekti i autostradës që sapo kemi realizuar, i jep Kosovës hap të hovshëm përpara në ndërtimin e një infrastrukturë të standardeve evropiane".

Shefi i qeverisë së Kosovës, u tha mysafirëve se ndikimi i këtij projekti infrastrukturor, do të përkthehet siç tha ai në nxitjen e tregtisë, bujqësisë, industrisë e turizmit.

Ai nga tribuna tha se shpejt do të nisë ndërtimi edhe i autostradës, Prishtinë-Shkup, e cila do të ndërli-dh edhe qytetin e Ferizajt dhe Kaçanikun me këtë infrastrukturë.

Takim me lexuesit u zhvillua në një vend të zgjedhur në zemër të Bukureshtit

MBRËMJE LETRARE NË BUKURESHT: KADARE DHE AMOS OZ

Botimi i romanit "Darka e gabuar" i Kadaresë në Bukuresht ka zgjuar interes të jashtëzakonshëm në mesin e lexuesve dhe mbështetësve të letërsisë shqiptare në Rumani. Dëshmi: debati i organizuar nga "Humanitas", Shtëpia Botuese, e cila zotëron të drejtat e veprave të Kadaresë. Takim me lexuesit u zhvillua në një vend të zgjedhur në zemër të Bukureshtit, në mjediset e librarisë "Kretzulescu" dhe me të ftuar dy prej kritikëve në modë në kryeqytetin rumun, Tania Radu dhe Marina Constantinescu. Në veprimtari folën dhe Andreea R?uceanu, kritik letrar dhe redaktor i shtëpisë botuese "Humanitas", si dhe përkthyesi i romanit, shkrimtari dhe gazetari Marius Dobresku.



Tema e takimit, "Dy anët e luftës, duke u nisur nga romanet Pantera nga nëntoka, nga Amos Oz dhe Darka e gabuar nga Ismail Kadare" grupoi kështu dy nga zërat më të famshëm të letërsisë bashkëkohore, izraelitin Amos Oz dhe shqiptarin Ismail Kadare. Ligjëruesit vunë në dukje se të dy romanet iu referohen ngjarjeve relativisht të afërta në kohë (1940-1950), por që janë zhvilluar në mjediset dhe kontekste krejtësisht të ndryshme.

Nëse romanin e Oz lufta është parë përmes syve pyetës të një fëmije dhe është sugjeruar me ngjyerat më të kthjellëta, ngjarjet në romanin e Kadaresë ndodhin në një atmosferë solemne, pothuajse të zymtë, të cilat përcakton nga epoka staliniste, e cila kishte pushtuar dy kontinentet nga stepat e Kazakistanit deri në bregdetin e Adriatikut.

Në fjalën e tij, përkthyesi i romanit, shkrimtari Marius Dobresku, skicoi kuadrin historik në të cilin vendos Kadare ngjarjet në roman,

duke filluar nga pushtimi italian dhe duke mbaruar me vdekjen e Stalinit, në mars 1953. "Komunizmi në Shqipëri solli një mori fatkeqësish për gjithë popullin, ndërsa eventimet që sollën vrasjen e doktor Gurameto inkuadrohen në paradigmen tragjike që konturoi shortin e këtij populli duke filluar nga viti 1944".

Nga ana tjetër, kritikja letrare Marina Constantinescu u shpreh se,

"Darka e gabuar" është një roman i dhimbshëm, me një tip drejtimi tejet personal, me një zë të fortë dhe që nuk të fal, siç është ai i Kadaresë, por, disi, dhe falës. Duke kaluar mbi të gjitha mizoritë, jo duke fshirë dhe anuluar, por duke sugjeruar një ndalesë të meditimt.

Andreea Raseanu, redaktore e librit, u shpreh në plotësim për librin e Kadaresë: "Pata për herë të parë ndjesinë që, më shumë se kurdo, Kadare tërhiqet në segmentin eliptik, në një makth më të vjetër të tij, dhe që në njëfarë mënyre braktis kontekstin historik, i cili pothuajse nuk ka më rëndësi. Të gjitha ngjarjet e mëdha që ndodhin në roman kanë një logjikë në mitologji, ngjarjet tragjike shihen si disa ndëshkime për disa mëkate të lasha që janë kryer këtu, në trevat e Gjirokastrës." Ngjarja në librarinë qendrore bukureshtare "Kretzulescu" u pasqyrua gjerësisht në shtypin e kryeqytetit rumun. Kadareja është shndërruar një brand i letërsisë europiane që mbledh rreth tij lexues të të gjitha moshave, me përvojë jetësore të ndryshme, që vlerësojnë në unison letërsinë cilësore.

Mira Skënderaj Bukuresht